

albislam

revistë e përmuajshme fetare kulturore shkencore

Viti VI nr: 56 / 1 Prill 2008 / 24 Rebiul Evvel 1429 / Çmimi: Maqedoni 50 den / Kosovë 0.80 euro / Shqipëri 100 lek

Letër tregtarit

■ Faqe 5

**Shikoni
prej kujt e
merrni fenë**

■ Faqe 42

**Shqiptari,
emigrimi dhe
identiteti i tij**

■ Faqe 52

**Bija ime
dhe periudha
e pubertetit**

ISSN 1409-6250



9 1 7 7 1 4 0 9 6 2 5 0 0 2

Kryeredaktor:
Omer BERISHA

Redaksia:
Bekir HALIMI, Talha KURTISHI,
Muhamed DËRMAKU, Agim BEKIRI,
Alaudin ABAZI, Ali SHABANI,
Lulzim SUSURI, Enver AZIZI,
Ulvi FEJZULLAHU
Sedat SHABANI

Bashkëpunëtorë:
Ekrem AVDIU, Ismail BARDHOSHI,
Enis RAMA, Ahmed KALAJA, Fadil MUSLIU

Redaktor gjuhësor:
Fatmir Baçi
Redaktor teknik & faqesës:
Halil BERISHA
Redaktor artistik & disenji:
Azem ZAIMI

Adresa:
rr: 110 nr: 5, Çarshia e vjetër
Shkup 1000
e-mail: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718
tel & fax: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar
pranë Agjencisë për Informata
të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 1500

ABONIMI NJËVJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Evropë: 20 €,
Kanada dhe Amerikë: 40 €
(në çmim janë të përfshira edhe
harxhimet postare)

NUN-R DOEL
Xhirollogaria: 300000001759616
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)
Xhirollogaria: 0270100209184
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)
Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4
S.W.I.F.T. : KOBBSMK2X
IBAN MK07300701002091869
Numri tatimor: 4030003487017

alb
ISLAM
DEL NË FILLIM TË MUAJIT



Hapësirë për reklamën tuaj



SEKRETI I NGADHËNJIMIT

3

Ditët që lamë pas shënuan kujtimin për lindjen e Muhamedit paqja dhe bekimi goftë mbi të, njeriut më me influencë gjatë tërë historisë.

Asnjë segment i jetës së tij nuk mbeti misterioz dhe i panjohur, por përkundër të tjerëve, ai i ofroi njerëzimit një libër të hapur të jetës së tij ku të gjithë mund të jenë lexues dhe përfitues.

Morali dhe jeta e tij sfiduan bashkëkohësit e tij dhe ata që erdhën pas, që të sjellin ndonjë provë e cila do ta njolloshte personalitetin e tij të pastër dhe misionin e tij të shenjtë.

Edhe këtë vit e pritëm këtë datë madhështore, dhe sikur më herët sfida mbeti e hapur, e që fatkeqësisht disa nga pamundësia dhe zilia e madhe për ta realizuar ëndrrën e kamotshme të gjyshërve të tyre, deshën që bile disi t'i qetësojnë eshtrat e tyre përmes disa karikaturave të ulëta të cilat nuk reflektojnë assesi inteligjencën e atyre të cilët i krijuan.

Ata të cilët me këmbëngulje insistojnë ta njollosin atë, nuk e bëjnë nga zilia që kanë për shkak se ai la pas vetes pasuri, apo ndonjë formulë të caktuar e cila do t'i mundësonte përjetësisht pasuesve të tij të jenë të parët në të gjitha mejdanet e kësaj bote.

Ndodh që të jetë e kundërta, sikur jemi dëshmitarë sot, që të tjerët të jenë të avancuar në sferat e ndryshme të kësaj bote materiale, por ajo e cila mbjell zili në zemrat e tyre dhe i shtyn vazhdimisht të jenë armiq të tij është çelësi i zemrave, dhëmbët e të cilët u gdhendën me mësimet e tij.

Ata të cilët e prezantuan përmes atyre karikaturave të shëmtuara, deshën që ashtu të duket, por magjia e goditi vet magjistarin, ku mu ato karikatura u bënë shkak që të tjerët të hyjnë në fenë e tij.

Të gjitha anketat dëshmojnë se feja që më së tepërmi pranohet anekënd botës e në veçanti në perëndim është feja islame.

Kështu që, sa më tepër mundohen ta njollosin atë, pastërtia e tij ngadhënjën gjithnjë mbi ta dhe kjo bënë që dikush të pastrohet e dikujt t'i shtohet mllëfi dhe zilia edhe më.

Ata që e pranojnë këtë fe dhe refuzojnë ta njohin të dërguarin përmes atyre karikaturave assesi nuk e bëjnë këtë për shkak të frikës së eksplodimeve që ndodhin kohë pas kohe, e as pse dikush i ka joshur me diç materiale, madje ata vet ikin nga kjo.

Deklaratat e tyre dëshmojnë të kundërtën ku ata shprehen botërisht se ajo që i bënë ta duan këtë të Dërguar është mirësjellja, paqja dhe siguria që ua ofrojnë mësimet e tij hyjnore.

Nga kjo që e thash nuk kam për qëllim që ne muslimanët mos të angazhohemi e të jemi të parët në të gjitha sferat, por ajo që kam për qëllim është të marrim mësim nga të gjitha këto beteja shekullore të zhvilluara mes Muhamedit salallahu alejhi ue selem dhe armiqve të tij, e të cilat qartazi e zbulojnë sekretin e këtij ngadhënjimi, i cili assesi nuk fshihet aty ku mendojnë shumica dhe insistojnë të garojnë me të tjerët aty, por fshihet në pasimin e tij dhe ngjalljen e moralit dhe virtyeteve të tija të larta.

Andaj ne muslimanët, do të jemi të pamposhtur dhe do të ngadhënjëjmë vazhdimisht dhe në anën tjetër do të kemi me çka të konkurrojmë në arenën ndërkombëtare vetëm atëherë kur mësimi i Teuhidit (besimit të patër) dhe njohja e thukhtë e traditës që e la pas ky i Dërguar i fundit do të jenë gjërat primare në agjendën e angazhimeve dhe mësimet tona.

Kur e them këtë nuk dua që të kuptohet se do të shuhet armiqësia dhe do të flaken karikaturat, por ajo që dua të kuptohet është, se nëse ne inspirohemi nga jeta e të Dërguarit për t'u ballafaquar me sfidat atëherë do të ngadhënjëjnë vlerat tona ndaj të atyre dhe të mençurit e tyre do të kenë mundësinë prej kujt të dëgjojnë.

*në emër të redaksisë:
Enis RAMA*

EDITORIAL

albiSLAM

Faqe 5

Shikoni prej kujt e merrni fenë



Faqe 13

Pas 20 vjetëve Islami je e parë në Bruksel



Faqe 14

Zhvillimi i sulmit të perëndimit ndaj Islamit



Faqe 19

T'i gëzosh muslimanët...
art i shpirtrave të bardhë



Faqe 23

Mirësjellja ndaj Muhamedit,
salallahu alejhi ue selem, (1/2)



Faqe 26

Mëkatimi ndaj Allahut Ademi dhe ne



Faqe 29

Në rrugë... sprovat



Faqe 32

Fuqia e argumentit 2/2



Faqe 36

Letër tregtarit



Faqe 42

Shqiptari, emigrimi dhe identiteti i tij



Faqe 47

Binjakët



Faqe 50

BËHU SI UMU SULEJM (Nëna e Sulejmit)



Faqe 52

Bija ime dhe periudha e pubertetit

Faqe 56

Rreth namazit...



Faqe 59

Dhikri pas namazit



Faqe 61

Njëzet Hadithe Të Zgjedhura Nga Sahihu I Muslimit



Shikoni prej kujt e merrni fenë

Shkruan: Bekir HALIMI

Islami ballafaqohet sot me një zgjim të mirë të myslimanëve dhe, dalëngadalë, fesë dhe bartësve të fesë është duke iu kthyer pozita. Në këtë zhvillim pozitiv, thirrja islame përballet me disa peripeci dhe sfida. Këto sfida dhe peripeci janë të zakon-

shme në këtë stadium të zhvillimit të fesë, veçanërisht në shoqëritë pas ateiste.

Ndërprerja e kulturës fetare në disa pjesë të shoqërisë shqiptare, mungesa e dijes fetare në disa pjesë tjera të kësaj shoqërie dhe mungesa e vull-

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

aktuale

netit për zbatim të drejtë edhe të asaj pak që është ditur në gjirin e pjesës së tretë të shoqërisë shqiptare, kanë nxjerrë përpara fenomenit “zgjim i myslimanëve” disa sfida dhe peripeci.

Nëse ndalemi dhe flasim për të gjitha sfidat, do të na mbushet tërë revista vetëm me këtë shkrim.

Mirëpo unë do të dëshiroja që këtë radhë të veçoja një problem, i cili është paksa i ri (në këtë formë) në gjirin e shqiptarëve dhe ka dalë në sipërfaqe si rrjedhojë e frymës së re fetare që po fryn në këto vatra.

Ne si myslimanë që jetojmë në periferinë e botës islame, me dëshirë apo pa dëshirë ndikohemi nga ajo që ndodh në botën islame, andaj edhe dalja në dritë e këtij fenomeni është rrjedhojë edhe e këtij fakti.

Porse, unë mendoj se ky fenomen ka ardhur mbi të gjitha si pasojë e drejt-përdrejtë e ndërprerjes së vazhdimësisë së fesë dhe jetës fetare dhe zhvillimit fetar në trevat tona. Në një kohë kur rendi i hoxhërisë ka humbur, kur janë prishur kriteret e hoxhës së mirë, kur ka munguar hoxha i vërtetë dhe kur njerëzit janë detyruar secilin që është thirrur si hoxhë ta konsiderojnë hoxhë për shkak të nevojës së madhe që kanë ndjerë për ta patur këtë simbol dhe për të kryer punët e zakonshme dhe të përditshme të jetës së tyre, sikurse është martesë, synetimi,

vdekja etj.

Në një kohë kur jetën fetare e ka kapluar molisja, institucionet fetare krimbja, kurse popullit i ka humbur vlera e referimit, i jepet shans secilit të paraqitet si shpëtimtar dhe alternativë.

Fatkeqësisht ky fenomen ka sjellë shfaqjen e shpëtimtarëve të vërtetë dhe të rrejshëm. Të sinqertit dhe të denjëit kanë dëshmuar me veprimet dhe jetën e tyre, kanë treguar nivelin intelektual që kanë, pjekurinë dhe maturinë fetare, sinqeritetin dhe dashamirësinë për popullin e tyre, nuk i kanë nxjerrë popullit sfida dhe fitne të cilat nuk mund t'i

gëlltisin apo t'i tejkalojnë, andaj i tërë populli i njeh si intelektualë të mirëfilltë fetarë, besnikë, të drejtë, të vërtetë, flijues, bamirës, e kështu me radhë. Në këso raste janë munduar të futen në këto radhë edhe disa të tjerë, të cilët, njëllon si në rrëfenjën e kalit me bretkosën, dëshiruan të mbathen me patkua, mirëpo ata nuk dëmtuan me këtë veprim vetëm vetveten, si në rastin e bretkosës, por edhe të tjerët.

Pa dyshim se krejt kjo paraqet tundim të madh për të rrëzuar referencat e vërteta të umetit, që në vend të tyre të paraqesin njerëzit liberalë si referencë e umetit apo ata të tjerët ekstremistë, palë të rëna nën ndikimin e irxhasë apo huruxhit, liberalë sa

"Do t'i vijë një kohë umetit tim ku do të shtohen lexuesit (e Kur'anit) e do të pakësohen fukahatë (dijetarët), dija do të largohet dhe do të shtohet herxhi. Thanë:

Resulullah, çfarë është herxhi? Tha: vrasja mes njëri-tjetrit. Pastaj do të vijë një kohë ku disa njerëz nga umeti im do ta lexojnë Kur'anin, mirëpo ky lexim nuk do ta kalojë fytin e tyre.

Pastaj do të vijë një kohë kur mynafiku do të polemizojë me kafirin dhe mushrikun rreth asaj që flasin ata".

s'bën apo fanatikë sa s'shkon.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem,, *“e la umetin e tij në rrugë të qartë dhe të ndritshme ku dita dhe nata janë njësoj, kush largohet nga kjo rrugë është i shkatërruar”*. (Ibën Maxhe, sahih).

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, na tregoi pastaj kush do ta bartë këtë dije fisnike, kush do të jetë në vargun e dijetarëve që do të ndërlihen me varg të pandërprerë me Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, duke thënë: *“Këtë dije nga çdo brez e bartin të drejtët. Ata e mbrojnë fenë nga devijimi i ekstremistëve, shthurja e njerëzve të kotë dhe komentet e gabuara të injorantëve”*. (Albani thotë se ky hadith është sahih).

Dijen fetare e ka përhapur Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, në gjirin e sahabëve, sahabët në gjirin e tabiinëve, kurse tabiinët në gjirin e nxënësve të tyre. Kështu u përhap dija fetare anë e mbanë rruzullit tokësor. Përderisa njerëzit kishin ambicie të larta dhe aspirata të mëdha, dija fetare mësohej dhe shpërndahej, mirëpo me dobësimin e fesë në zemrat e njerëzve, me zvogëlimin e ambicieve dhe aspiratave, u pakësua numri i atyre që mësojnë fenë, madje, myslimanët filluan mos ta përfillin më këtë lëmi, duke u dhënë përparësi fushave të tjera, u pakësuan dijetarët dhe dija u largua. Imam Ibën Abdul-Beri, rahimehullah, në librin e tij shumë të vlefshëm, që flet për vlerën e dijes, ka një kapitull me titull **“Trans-**

metimet mbi largimin e dijes dhe ikjen e dijetarëve”, ku mes të tjerave janë edhe këto hadithe dhe fjalë të dijetarëve të selefit.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Do të shfaqen fitne (sprova, telashe) dhe do të shtohet herxhi. I thanë: çfarë është herxhi? Tha: vrasja, vrasja dhe do pakësohet dija”*.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Allahu s'e largon dijen duke e marrë nga gjoksi i dijetarëve, por me vdekjen e tyre. Kur të mos mbeten dijetarët, njerëzit do të marrin të paditurit për dijetarë, e do t'i pyesin dhe ata do t'u përgjigjen. Kështu do të devijojnë ata dhe do t'i devijojnë të tjerët”*. (Buhariu).

Kur të shterojnë dijetarët, atëherë dikush do mundohet të zërë vendin e dijetarëve, njerëzit do fillojnë të marrin dijen e fesë prej të vegjëlve, apo njerëzve të thjeshtë dhe pa kapacitet intelektual dhe fetar.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Prej shenjave të Kiametit është: largimi i dijes; përhapja e padituri; konsumimi i alkoolit; shfaqja e zinasë”*.

Në kohën e fundit është shfaqur edhe një kategori njerëzish, që u thonë fillestarëve: Mos u referohuni librave, as dijetarëve, por lexoni Kur'anin dhe Hadithet dhe prej tyre nxirrni dispozitat fetare. Shumica e këtyre që thonë këto fjalë s'dinë ta lexojnë Kur'an si duhet, mos flasim për kuptimin e domethëniesve të ajeteve.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Prej shenjave të Kiametit është pakësimi i dijes, përhapja e padituri, shfaqja e zinasë, shtimi i grave dhe pakësimi i burrave, aq sa një burrë do të kujdeset për pesëdhjetë gra”*.

Imam Ibën Haxheri, rahimehullah, duke komentuar këtë hadith mes tjerash thotë: *“Me sa duket, këto pesë gjëra*

janë përmendur qëllimisht, sepse prishja e këtyre gjërave prish jetën e dynjasë dhe ahiretit. Largimi i dijes prish fenë, konsumimi i alkoolit prish mendjen, zinaja prish sojin dhe prejardhjen e shpirtin, ndërsa pasurinë e dëmtojnë mungesa e sigurisë me përhapjen e vrasjeve.

Kermaniu, rahimehullah, thotë: "Prishja e këtyre gjërave lajmërojnë prishjen e botës, sepse njerëzit nuk braktisen kot".

Kurtubiu, rahimehullah, duke komentuar këtë hadith, thotë: "Në këtë hadith ka argument për profecinë e Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, sepse lajmëroi për disa gjëra që do të ndodhin dhe ato kanë ndodhur pikërisht ashtu siç i ka treguar ai, sidomos në këto kohë (autori flet për kohën e tij).

Abdullah b. Mesudi, radijAllahu anhu, thotë: "Jepuni pas dijes para se të largohet, e largimi i saj domethënë ikja e bartësve të saj (dijetarëve)".

Auf b. Malik Eshxhaiu, radijAllahu anhu, thotë: "Ishim duke ndenjur me Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, e ai papritmas pa në qiell, e tha: Kjo është koha e largimit së dijes. Një prej Ensarëve, i cili quhej Zijad b. Lebid tha: a mund të largohet dija duke patur mes nesh Kur'anin, të cilin e dinë gratë dhe fëmijët tanë? Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem,, tha: Të kam menduar më të diturin e banorëve të Medinës. Pastaj ia tregoi devijimin e Ehli Kitabit edhe pse kishin mes tyre Librin e Zotit.

Khubejr b. Nefiri takoi më vonë Shedad b. Eusin në Musala (vend i caktuar për falje) dhe ia tregoi këtë hadith të Auf b. Malikut, kurse

Shedadi i tha: të vërtetën ka treguar Aufo. Pastaj tha: a e di se çfarë domethënë largimi i dijes? I thashë: jo. Tha: ikja e bartësve të dijes. A e di se cila dije do të largohet e para? I thashë: jo. Tha: përulja (në namaz), aq sa nuk do të shohësh askënd të përulur".

Muhamed b. Sirini, rahimehullah, thotë: "iku dija, s'ka mbetur asgjë më shumë se disa gjëra të vogla në bartës të këqij".

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: "*Do t'i vijë një kohë umetit tim ku do të shtohen lexuesit (e Kur'anit) e do të pakësohen fukahatë (dijetarët), dija do të largohet dhe do të shtohet herxhi. Thanë: Resulullah, çfarë është herxhi? Tha: vrasja mes njeri-tjetrit. Pastaj do të vijë një kohë ku disa njerëz nga umeti im do ta lexojnë Kur'anin, mirëpo ky lexim nuk do ta kalojë fytin e tyre. Pastaj do të vijë një kohë kur mynafiku do të polemizojë me kafirin dhe mushrikun rreth asaj që flasin ata*". (fq. 217- 222)...

Pa dyshim, këto hadithe dhe fjalë të selefit na frikësojnë shumë për gjendjen e umetit dhe na vënë në gjendje alarmi të gjithëve për të mësuar fenë dhe për t'ua mësuar të tjerëve, e kështu ta përhapim dijen e fesë dhe të shtojmë numrin e atyre që e bartin këtë dije fisnike. Kështu do të vazhdojmë rrugën e dijetarëve që kanë ecur përpara nesh, marrim dijen prej dijetarëve derisa të bëhemi edhe ne dijetarë e trashëgues të tyre.

Në lidhje me këtë çështje do të sjellim edhe një sqarim të shejh Salih El-Feuzan, Allahu e ruajt, që mes të tjerave thotë: "Dija fetare, ajo që është obligim individual dhe ajo që është obligim kolektiv, merret nga dijetarët

të cilët e kanë bartur me besnikëri, sikurse ka thënë Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem,: *“Këtë dije nga çdo brez e bartin të drejtët”*. Dhe ka thënë: *“Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve”*. Ashtu sikurse dija merret nga Pejgamberët kur ata janë gjallë, ashtu merret nga trashëguesit e tyre pas vdekjes, e ata janë dijetarët. Toka, falë Zotit, kurrë nuk do të mbetet pa dijetarë.

Myslmanët duhet ta marrin dijen prej tyre dhe të veprojnë sipas udhëzimeve të tyre. Mirëpo, fatkeqësisht, vitet e fundit, shohim shumë njerëz që dëshirojnë të mësojnë dijen fetare, sidomos të rinjtë, i janë shmangur kësaj rruge, i shmangen marrjes së dijes nga dijetarët besnikë dhe e marrin dijen ose nga njerëz të paditur, të cilët nuk perceptojnë dispozitat fetare dhe vendin e hallallit dhe haramit, ose prej njerëzve që nuk njihen si besnikë dhe me besim burimor dhe të pastër. S’ka dyshim se ky veprim nuk do t’i shpjerë në fund të lumtur.

Dijetarët e Selefitt kanë thënë: **“Kjo dije është fe, andaj bëjini sytë katër prej kujt e merrni fenë tuaj”**. Kurse Abdullah b. Mesudi, radijAllahu anhu, ka thënë: “Njerëzit do të vazhdojnë të jenë në mirësi përderisa dijen e marrin nga dijetarët, të mëdhenjtë e të moshuarit e tyre. Kurse kur t’ju vijë dija nga të vegjlit dhe mendjelehtit, ata do të shkatërrohen”.

O djelmoha! O nxënës të dijes! Kontaktoni me dijetarët tuaj, lidhuni për ta, merreni dijen prej tyre, lidhuni me ata dijetarë që janë të njohur për besimin dhe metodën e saktë, e kështu të futeni në vargun e atyre që

kanë marrë dijen nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem...

Ka edhe një kategori tjetër të atyre që mundohen ta mësojnë fenë duke e marrë vetëm prej librave dhe duke mos kontaktuar aspak me dijetarët, duke menduar se i mjaftojnë librat dhe s’ka nevojë për dijetarët. Pa dyshim se ky veprim është gabim i rëndë dhe sjell rrezik shumë të madh, sepse të gjitha librat përpos Kur’anit Famëmadh dhe Synetit të Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, kanë gjëra të sakta dhe të gabuara, madje, në disa ka edhe gjëra të futura dhe gënjeshtër mbi fenë Islame dhe të shtyjnë në dyshime. Një nxënës fillestar nuk mund të bëjë dallimin mes asaj që është e dobishme dhe e dëmshme, ndoshta gabimi i mbetet në kokë. Për këtë themi se ky nxënës duhet të ketë një mësues largpamës, i cili i zgjedh librat, i tregon gjërat e dëmshme dhe të dobishme, të saktat dhe të gabuarat. Për këtë shkak nxënësit e dijes kanë udhëtuar në të kaluarën me mijëra kilometra për të marrë dijen nga dijetarët dhe nuk janë mjaftuar me shfletimin e librave. Kështu ka vepruar Imam Ahmedi, imam Buhariu etj. Po t’u mjaftonin librat, do të arrinin t’i gjenin e s’do të lodheshin aq shumë në atë kohë që s’kishte as vetura, as aeroplanë. E thënë shkurt: librat janë vetëm mjet dhe nuk mjaftojnë vetëm ato pa mësues.

Në kohën e fundit është shfaqur edhe një kategori njerëzish, që u thonë fillestarëve: Mos u referohuni librave, as dijetarëve, por lexoni Kur’anin dhe Hadithet dhe prej tyre nxirrni dispozitat fetare. Shumica e

këtyre që thonë këto fjalë s'dinë ta lexojnë Kur'an si duhet, mos flasim për kuptimin e domethënieve të ajeteve. Kjo kategori është më e rrezikshme se kategoritë e tjera, sepse këta s'dinë as rregullat e argumentimit, ndërsa dihet se ka argumente që janë të qarta (**muhkem**) dhe të paqarta (**muteshabih**), të përgjithësuar (**muxhmel**) dhe të sqaruara hollësisht (**mubejen**), të përgjithshme (**Am**) dhe të veçanta (**Has**), të pakufizuara (**Mutlak**) dhe të kufizuara (**mukajed**), etj. Kurse hadithet, disa prej tyre janë sahih, disa hasen, disa daif, disa meudu', e kështu me radhë...

Format e nxjerrjes së dispozitave fetare i dinë vetëm dijetarët e thelluar në shkencat e fesë, madje, jo të gjithë dijetarët, e ç'mbetet të themi për këta fillestarë që sulmojnë argumentet dhe dispozitat pa dije. Ata duhen ndalur, që mos të shkatërrojnë vetveten dhe të tjerët...".

Këtyre sqarimeve që ka bërë ky hoxhë i madh do t'i shtojmë edhe disa hadithe dhe fjalë të selefit që i ka sjellë Imam Ibën AbdulBerri në librin e tij mbi dijen fetare dhe vlerën e saj, ku mes të tjerave sjell një kapitull me titull **"Gjendja e dijes fetare kur të gjendet tek mëkatarët (e prishur) dhe të poshtrit"**.

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem,, thotë: **"Prej shenjave të Kiametit është marrja e dijes nga të vegjlit"**.

Ebu Naimi thotë: e pyetën Ibën Mubarekun: kush është i vogli? Tha: ata që flasin me mendjen e tyre, kurse një i vogël që transmeton nga një i madh, ky s'është i vogël". Ebu Ubejdi

thotë: sipas meje, marrja e dijes nga i vogli është marrja e dijes pas brezit të sahabëve". Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: *"Bereqeti (në dije) qëndron me të mëdhenjtë tuaj"*. Omeri, radijAllahu anhu, thoshte: "Fjala më e drejtë është fjala e Allahut, kurse udhëzimi më i mirë është ai i Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, dhe gjërat më të këqija janë ato të shpikurat. Njerëzit do vazhdojnë të jenë në mirësi përderisa t'u vjen dija nga të mëdhenjtë". Abdullah b. Mesudi, radijAllahu anhu, thotë: "Njerëzit do vazhdojnë të jenë në mirësi përderisa dijen e marrin nga të mëdhenjtë, e kur fillojnë ta marrin nga të vegjlit dhe të këqijtë, atëherë do të shkatërrohen". Abdullah b. Omeri, radijAllahu anhu, thotë: "Do të vazhdoni në mirësi përderisa dija merret nga të mëdhenjtë tuaj, dhe kur dija të bjerë te të vegjlit tuaj, atëherë i vogli do të zhvlerësojë të madhin e do ta konsiderojë mendjelehtë". Pasi përmend këto gjëra hafidh Ibën AbdulBerri thotë: "Mund të kuptohet lehtë se domethënia e këtyre haditheve është se njerëzit më meritore për ta mësuar dijen dhe fikhun janë ata që janë të ndershëm, fetarë dhe që gëzojnë autoritet. Sepse, nëse dija gjendet tek ata, askush s'pranon të ulet para tyre, ndërkohë që, nëse është te të tjerët, shejtani do të gjejë mënyrën për t'i nënçmuar dhe njerëzit do të parapëlqejnë të mbeten të paditur vetëm e vetëm që të mos ulen tek ai që s'ka soj e as fe. Andaj edhe e ka llogaritur këtë vepër si një prej shenjave të Kiametit e si një prej shkaqeve të largimit të dijes..."

Pastaj sjell një fjalë të Ferjabiut, i cili

thotë: “Imam Sufjan b. Ujejne kur shihte se disa njerëz pa soj shkruanin meseletë e fesë prej tij, i ndryshohej fytyra. I thashë: Ebu Abdullah, vërejmë se ndihesh keq kur sheh këta njerëz duke shkruar meseletë që mësojnë prej teje? Tha: Dija tek arabët ishte tek njerëzit më zotërinj e kur u largua prej tyre dhe kaloi tek këta (d.m.th. të pakulturuar dhe të poshtër), u ndryshua feja”. (fq. 223-226).

Njerëzit që s’i shoqërojnë dijetarët në rrugën e nxënies së dijes dhe nuk e marrin dijen prej tyre, për një kohë të shkurtër u duket se kanë arritur grada shumë të larta dhe se kuptojnë shumë gjëra të cilat ndoshta as dijetarët e mëdhenj nuk i kuptojnë. Ky njeri, me dijen e cekët që ka, futet në ujërat e turbullta të vetëkënaqësisë dhe mendimit për vete se askush s’mund t’i afrohet në gradën që ka. Kjo gjendje dhe ky mendim i tij për vetveten nuk i lejon të vazhdojë nxënien e dijes, as i mundëson shtimin e saj dhe e dëmton këtë njeri në dy aspekte:

-U imponohet njerëzve si referencë kryesore dhe i ndalon nga referencat e tjera, duke rrëmuar dhe kritikuar tek ata gabime të vogla, të cilat i ka çdo njeri.

-E mëson xhematin e thjeshtë që edhe ai të mendojë kështu për veten e vet dhe fillon të hulumtojë gabimet e dijetarëve dhe të nxënësve të dijes dhe t’i publikojë ata mes njerëzve që të

Ne jemi dëshmitarë të sprovimit të myslimanëve nga disa nxënës dije të vegjël në këtë formë. Mësimet e tyre i fillojnë me kufrin, përpara se t’u mësojnë besimin, imanin; e fillojnë me bidatin, përpara se t’u mësojnë Synetin; e fillojnë me dispozitat e ligjit Islam për kundërvajtjet e krimet, përpara se t’u mësojmë pastërtinë dhe namazin.

justifikojë mosrespektimin e tyre.

S’ka dyshim se kjo mënyrë e komunikimit me dijetarët dhe xhematin krijon një kaos të madh në fushën e dijeve fetare, në përzierjen e gradave të xhematit, nxënësit të dijes dhe dijetarëve, aq sa një xhematli i thjeshtë mendon se mund të bëhet nxënës dije, madje edhe myfti, kurse një nxënës dije mund të llogarisë veten shejhul-Islam, e kështu me radhë. Këtë gjë e kanë vërejtur dijetarët edhe

më herët mes myslimanëve, andaj, ja se çfarë thotë Ebu Hazimi, i cili, duke folur për kohën e vet, thotë: “Në kohën tonë akuzojnë njerëzit ata që kanë dije më shumë se ata, që të kuptojnë njerëzit se ai s’ka nevojë për të, nuk mëson prej atij që është si ai, tregohet mendjemadh ndaj atij që është ndër ta. Kështu shkoi dija dhe u shkatërruan njerëzit”. (fq. 532).

Ndërkaq, njerëzit fisnikë sillen në këtë mënyrë: “Kohë më parë, dijetarët kanë thënë: një njeri fisnik nuk tregon mendjemadhësi në katër raste: kur ngrihet në këmbë për babanë; kur i shërben mysafirrit; kur kujdeset për të atin, edhe pse ka shërbëtorë, dhe kur i shërben dijetarit për të marrë dijen prej tij”. (fq. 190). Abdurahman b. Mehdiu, rahimehullah thotë: “Nuk mund të jetë imam në hadith ai që grumbullon hadithet **shadhë** (lloj i haditheve të dobëta), flet tërë ato që dëgjon dhe transmeton nga një njeri i

çfarëdoshëm”.

Edhe sot ka njerëz që hulumtojnë gjëra që s'i ka treguar askush dhe i tregojnë për t'u dalluar prej tjerëve, apo të jenë të parët që kanë sjellë diçka të re, apo t'i nxjerrin gabim të gjithë dijetarët. Mirëpo kjo është në kundërshtim me pedagogjinë islame gjatë dhënies së dijes fetare, sepse dijetarët e selefit kanë dhënë këshilla të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Abdullah b. Mesudi, radijAllahu anhu, thotë: “Nëse u flet njerëzve gjëra që mendja e tyre s'i kupton, ajo bëhet fitne (telash dhe sprovë) për ta”. Urve b. Zubejri, radijAllahu anhu, thotë: “Sa herë që i kam treguar dikujt gjëra që s'ia ka nxënë koka, është bërë shkak për devijimin e tij”. Ebu Kulabe thotë: “Mos i trego mësimet atij që s'i kupton, sepse ai që s'i kupton më shumë e dëmtojnë sesa i bëjnë dobi”. Aliu, radijAllahu anhu, thotë: “Flitini njerëzve gjëra që kuptojnë, apo dëshironi të përgënjeshtrohet Allahu dhe Pejgamberi i Tij?”. (Shih: “Sahihu Xhami'i Bejanul-Ilmi ve Fadluhu”, fq. 186- 187).

Ne jemi dëshmitarë të sprovimit të myslimanëve nga disa nxënës dije të vegjël në këtë formë. Mësimet e tyre i fillojnë me kufrin, përpara se t'u mësojnë besimin, imanin; e fillojnë me bidatin, përpara se t'u mësojnë Synetin; e fillojnë me dispozitat e ligjit Islam për kundërvajtjet e krimet, përpara se t'u mësojnë pastërtinë dhe namazin. S'ka dyshim se kjo mënyrë sjell telashe, sprova dhe trazira mes myslimanëve, sepse godina e piramidës së dijes është venduar mbrapsht, e sipas rregullit duhet të jetë në bazament e gjerë dhe e gjatë,

kurse në kokë e ngushtë dhe e hollë, kurse tek këta njerëz në bazamente është e ngushtë dhe hollë, kurse në kokë e trashë dhe e gjerë.

Abdullah b. Abasi, radijAllahu anhu, duke komentuar termin “dijetar hyjnor - **alim rabbani**” thotë: “Dijetar hyjnor është ai që u mëson njerëzve gjërat e vogla përpara se t'u mësojë të mëdhatë”. Kështu duhet të veprojmë me xhematin, nëse dëshirojmë të qëndrojmë besnikë në rrugën e selefit dhe dijetarëve të mëdhenj. Nuk duhet të lejojmë që xhematit të klasës së parë t'i tregojmë mësimet për në fakultet apo studime pas universitare, sepse me këtë veprim tregojmë mungesën e njohurive mbi metodologjinë e selefit në përhapjen e fesë dhe mësimin e myslimanëve dhe shkaktojmë trazira të mëdha dhe të rrezikshme e të dëmshme për myslimanët e vendeve tona.

Hasan Basriu, rahimehullah, thotë: “Kush punon pa dije është si ai që ecën në rrugë të gabuar; ndërkohë që, ai që vepron pa dije më shumë prish sesa ndërton. Kërkoni dije në atë formë që nuk e dëmtoni adhurimin, ibadetin, bëni ibadet në atë formë që nuk e dëmtoni dijen, sepse disa njerëz kërkuan adhurimin dhe lanë dijen derisa dolën me shpatë kundër umetit të Muhamedit, salallahu alejhi ue selem,, e po të kishin kërkuar dijen, s'do t'i kish lënë të bënin këtë që bënë”. Dijetarët më herët kanë parë nga cili e marrin dijen dhe kë kanë mësuës. Andaj edhe kanë thënë: “**na i tregoni mësuësit tuaj**” që të kuptojnë se ku janë ata me dijen e tyre.

Pas 20 vjetëve Islami fe e parë në Bruksel

Sipas studimit të gazetës “La Liber Belgik”, del në shesh se feja Islame do të bëhet feja e parë në kryeqytetin belg, Bruksel, brenda njëzet viteve të ardhshme, kurse emri Muhamed është në majë të listës së emrave më të regjistruar që nga viti 2001.

Gazeta franceze “La Figaro” citon Olef Sarfin, profesorin e sociologjisë, në universitetin Katolik në Loven, i cili ka thënë: “Një e treta e banorëve të Brukselit momentalisht janë myslimanë, kurse, sipas parashikimeve, myslimanët në këtë vend brenda pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet do të bëhen shumicë për shkak të lindshmërisë së madhe që kanë”.

Mirëpo deputeti socialist në parlamentin francez në Bruksel **Mahfudh Ramadani** dyshon në këto informata, duke thënë: “Emigrantët nga vendet myslimane nuk janë të gjithë myslimanë”, duke aluduar në vetveten, i cili e ndien veten ateist. Madje, edhe vetë Sarfi është i kujdesshëm në këtë drejtim, duke thënë: “Duhet marrë në konsideratë edhe numrin e madh të evropianëve që ngulen në Bruksel për shkak se është kryeqyteti i Bashkimit Evropian”.

Kjo gazetë arrin te përfundimi: “nëse prindërit e brezit të parë të myslimanëve

nuk dalloheshin në fetarizëm për shkak të dëshirës për integrim, sot të rinjtë myslimanë në Belgjikë shënojnë një kthim të dukshëm në fe”. Sipas tyre 75% e myslimanëve të këtij vendi e zbatojnë fenë. Gazetarja belge **Hind Frihi**, autore e librit “Përvjedhësja tek islamistët fundamentalistë” shkon edhe më larg e thotë: “Ekstremizmi rritet mes të rinjve, ata refuzojnë vlerat perëndimore, gjë që shkakton frikë te prindërit e tyre. Në Bruksel ka lagje, si **Molebegu**, kur je aty, nuk vëren se je në Belgjikë”.

*Marrë nga: Islamtoday.net
Përshtati: B. H.*



Zhvillimi i sulmit të perëndimit ndaj Islamit

Basim HAFAXHI

EEtapa e dytë e përplasjes – nga marginalizimi drejt eliminimit Etapa e re e përplasjes mes perëndimit dhe Islamit, e cila ka filluar nga viti 2007, është më e rrezikshme, sepse synon kalimin nga marginalizimi i Islamit në eliminimin e tij, shuarjen e ndikimit të tij ndërkombëtar dhe mobilizimin e mbarë botës në armiqësinë kundër tij. Disa myslimanë mendojnë se është mendjelehtësi dhe e pamundur që dikush në perëndim të mendojë në këtë mënyrë, mirëpo është fakt se disa ideologë aleatë të neo-konservatorëve e mendojnë këtë gjë, duke tentuar që të shuajnë ndikimin ndërkombëtar të Islamit dhe trajtimin e tij nga bota si kult (sekt), dhe jo si fe. Domethënë, të bëhet fe e refuzuar ose sekt jashtë rregullave ndërkombëtare, e njerëzit të turpërohen t'i atribuohen kësaj feje apo sekt.

Ky është thelbi i eliminimit të Islamit tek këta ideologë ekstremistë. Në të ardhmen ata do të

rrahin manovra nga më të ndryshmet, programe dhe projekte, për të realizuar synimet e tyre, të cilat mund të lexohen nga planet dhe projektet e tyre të publikuara.

Në vijim do të përmendim disa simptoma të planeve të disa perëndimorëve, që synojnë kalimin e përplasjes me Islamin dhe myslimanët në një etapë të re, që ndryshon nga etapa e kaluar, e cilësuar me armiqësi, ashpërsi dhe qartësi shtesë.

- Stimulimi i braktisjes së fesë në botën Islame dhe mbrojtja e të drejtave të fe-mohuesve (murteeddëve).

- Eliminimi i kombeve, marginalizimi i tyre, duke u përqendruar në iluzionet e bashkëjetesës së njëanshme.

- Nxitja e mbarë botës për t'u armiqësuar me Islamin.

- Njësimi i qëndrimeve të armiqve të Islamit dhe koordinimi i aktiviteteve të tyre.

- Futja e dyshimeve mbi Islamin tek myslimanët dhe përkrahja e sekteve të devi-

Ky është thelbi i eliminimit të Islamit tek këta ideologë ekstremistë. Në të ardhmen ata do të rrahin manovra nga më të ndryshmet, programe dhe projekte, për të realizuar synimet e tyre, të cilat mund të lexohen nga planet dhe projektet e tyre të publikuara.



juara.

Për arritjen e këtyre synimeve do të harxhohen shumë mund, ide dhe mjete financiare, të koordinuara mirë mes tyre, për të arritur deri tek largimi i ndikimit të Islamit në arenën ndërkombëtare, që më pas ta largojnë nga ndikimi shoqëror, akaidologjik e ideologjik brenda shoqërive myslimane, për t'i hapur më pas rrugën shëmtimit maksimal ndaj Islamit në të gjitha rrafshet, për t'i penguar të gjithë ata që janë fetarë ta publikojnë fenë e tyre ose të thërrasin në të, e në fund, kushdo që i përket Islamit, i publikojnë këtë përkatësi me etiketime stereotipie, të cilat e nxjerrin njeriun nga rryma e përgjithshme shoqërore në margjinat e shoqërisë dhe jetës, gjë që shpie gradualisht deri te turpërimi nga publikimi i Islamit, dhe kështu, në mënyrë praktike, realizohet marginalizimi i rolit të

Islamit dhe shuarja e rolit të kësaj feje në shoqëritë që i përkasin kësaj feje.

A mund të realizohet kjo që thamë?

A ka mundësi që armiqtë në perëndim të mendojnë në këtë mënyrë?

Koha që vjen do na i tregojë shumë argumente se në perëndim ka njerëz që mendojnë dhe planifikojnë në këtë mënyrë dhe veprojnë seriozisht për realizimin e këtyre synimeve.

Në vijim do të prezantojmë synimet më të rëndësishme dhe mjetet dhe planet e realizimit të tyre:

1- Motivimi i braktisjes së fesë në botën Islame.

Në një të ardhme të afërt bota do të jetë dëshmitare e presioneve mediatike dhe ideologjike ndaj botës Islame jo vetëm në drejtim të debatit mbi temën e fe-mohimit, por edhe të drejtave të

tyre në botën Islame, me qëllim që të garantohet veprimtaria e lirë e misionarëve në botën Islame.

Kjo dukuri do të zgjerohet sa të krijojë të drejtën për akuza ndaj Islamit, ftesën drejtuar të tjerëve për të braktisur Islamin dhe themelimin e organizatave që do të mbrojnë të drejtat e femohuesve. E tërë kjo do të bëhet nën parullën “tolerancë dhe të drejtat e femohuesve”.

2- Eliminimi i kombeve, marginalizimi i tyre, duke u përqendruar në iluzionet e bashkëjetesës së njëanshme.

Në një të ardhme të afërt do flitet me të madhe për rëndësinë e bashkëjetesës me perëndimin si zgjidhje e vetme për umetin Islam në raportet e tij me perëndimin. Duhet thënë se perëndimi e ka bërë këtë hile të bashkëjetesës edhe me Evropën lindore, gjatë kohës së luftës së ftohtë. Ndërsa i thërriste popujt e Bashkimit Sovjetik dhe shtetet e Evropës lindore në bashkëjetesë sipas modelit të perëndimit, liderët e perëndimit shfrytëzonin të gjitha aftësitë dhe mundësitë për të fituar mbi komunizmin në të gjitha rrafshet, në atë ushtarak, ekonomik e kulturor.

Bashkëjetesa ish një projekt për të argëtuar kampin e lindjes dhe për ta angazhuar atë me qëllim që ta verbëronte karshi synimit të vërtetë të perëndimit, i cili ishte eliminimi total të rivalit ushtarak komunist dhe pengimin e zgjerimit të tij apo sfidimit të hegemonisë perëndimore.

Ne ballafaqohemi sot në të njëjtën mënyrë me perëndimin. Ata i thërrasin popujt në bashkëjetesë, kurse në anën tjetër përdorin të gjitha mjetet dhe mundësitë për të fituar mbi projektin ideologjik rival, që paraqet fenë Islame.

A do të pranojmë që feja Islame të dështojë për shkak të iluzionit të bashkëjetesës, të cilit nuk i përmbahet as ai që thërret në te.

3- Nxitja e mbarë botës për të armiqësuar Islamin.

Perëndimi, pas ngjarjeve të 11 shtatorit të 2001, ka rrahur ta skajojë umetin islam gjatë përplasjes me lëvizjet rezistuese, duke shpallur pandarë se feja islame është fe e tolerancës dhe se perëndimi ka problem vetëm me terrorizmin. Kjo politikë korri sukses përkohësisht në dhënien pozitive perëndimit që të koncentrojë të gjithë forcën e tij drejt lëvizjeve rezistuese dhe ushtarake. Por ja që vitet e kaluara u shfaq haptas fytyra e vërtetë e pikëpamjeve të këtyre njerëzve. Ata kaluan nga biseda rreth ekstremizmit islamik në bisedë rreth ekstremizmit të Islamit, kaluan nga sulmi drejt disa ekstremistëve brenda shoqërive myslimane drejt akuzimit të secilit që i përket Islamit dhe refuzon ndonjë veprim të perëndimit, duke e trajtuar si ekstremist.

Ky ndryshim ishte fillimi i projektit të sulmit ndaj Islamit si fe dhe besim, e jo vetëm ndaj ekstremistëve apo atyre që rrahin ta përdorin Islamin për të realizuar synime politike apo militante, sikurse pretendonte perëndimi në fillim të përplasjes.

Me këto sulme, që nënkuptojnë akuza ndaj tërë Islamit, ndaj profetësisë së Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, kontestimi se Kur’ani është shpallje etj., filloi fushata e organizuar për të armiqësuar tërë botën me Islamin. U shfaqën disa libra që tentonin ta shëmtonin fotografinë e Islamit

dhe Pejgamberit të Islamit, sulmonin Kur'anin dhe rishkruanin historinë islame, për ta paraqitur të përgjakshme dhe larg parimeve të civilizimit bashkëkohor. Ata filluan të rrihnin që të zvogëlonin vlerën e çështjes së civilizimit islam, rolin e tij në periudhën e Rilindjes dhe në historinë e njerëzimit, anashkaluan sukseset e myslimanëve e tentuan t'i përvetësojnë në çdo formë. Kjo do të vazhdojë edhe në etapën e ardhshme, madje do të bëhet edhe më e nxehtë dhe armiqësore.

4. Bashkimi i armiqve të Islamit dhe koordinimit mes tyre

Aktivistet e projektit perëndimor për shuarjen e Islamit rrahin për të koordinuar kontributin e armiqve të Islamit brenda tërësisë myslimane dhe jashtë saj. Nga jashtë ata themelojnë shoqata të ndryshme për fe-mohuesit, për shekullaristët myslimanë dhe për myslimanët liberalë dhe shumë emërtimeve tjera, të cilat synojnë eliminimin e Islamit. Ata do t'i përkrahin këto lloj organizatash dhe shoqatash dhe do të veprojnë për koordinimin e aktivitetit të tyre, do t'u japin pompozitet mediatik dhe heroizëm veprimeve të tyre në përplasje me Islamin, gjë që është duke ndodhur në mënyrë të qartë këto vitet e fundit.

Në të ardhmen, ata do të sajojnë një konflikt tjetër brenda tërësisë myslimane. Ky konflikt do të zhvillohet rreth një miliard myslimanëve, të cilët

s'i përkasin asnjë rryme aktive islame dhe s'e armiqësojnë Islamin. Perëndimi do të tentojë të gjithë ata që nuk i përkasin rrymave islame t'i rendisë në radhët e të moderuarve sipas kuptimit amerikan të këtij nocioni, me qëllim që të shikohet lëvizja islame si një pakicë ekstremiste brenda umetit Islam. Nga ana tjetër, lëvizja islame mund të korrë sukses, të gjithë ata që s'kundërshtojnë fenë Islame janë më shumë se një miliard myslimanë, kështu që, ata që përkrahin moderimin sipas kuptimit perëndimor, janë thjesht pakicë ekstremiste e armiqësuese ndaj fesë Islame. Nuk është e lehtë të parashikohet se si do të përfundojë ky konflikt, mirëpo dihet se do të jetë konflikt i ashpër rreth kësaj pjese të madhe të myslimanëve.

5. Futja e dyshimeve mbi Islamin tek myslimanët dhe përkrahja e sekteve të devijuara.

Gjatë etapës së ardhme, perëndimorët do të përkrahin këdo që kontribuon në futjen e dyshimeve në gjirin e myslimanëve rreth fesë së tyre. Kjo etapë do të dëshmojë hapjen e debateve rreth premisave islame, siç është argumentimi me Synet, a ka pësuar Kur'ani ndryshim, a janë të vlefshme dispozitat e Islamit për çdo kohë dhe vend etj. Ata do të mundohen që të fshijnë dallimin mes myslimanëve dhe të tjerëve në lidhje me pamjen e tyre, duke sulmuar vazhdimisht hixhabin, mjekrën dhe disa pamje të tjera, që tregojnë zbatimin praktik të fesë, duke shëmtuar këto manifestime dhe duke i thirrur myslimanët mos t'i përmbahen hollësisht këtyre rregullave.

Ata do të mundohen që të fshijnë dallimin mes myslimanëve dhe të tjerëve në lidhje me pamjen e tyre, duke sulmuar vazhdimisht hixhabin, mjekrën dhe disa pamje të tjera, që tregojnë zbatimin praktik të fesë, duke shëmtuar këto manifestime dhe duke i thirrur myslimanët mos t'i përmbahen hollësisht këtyre rregullave.

mjekrën dhe disa pamje të tjera, që tregojnë zbatimin praktik të fesë, duke shëmtuar këto manifestime dhe duke i thirrur myslimanët mos t'i përmbahen hollësisht këtyre rregullave. Ata do përkrahin sektet e ndryshme jashtë lëvizjeve islame, do kërkojnë të drejtat e tyre, siç është publikimi identitetit të tyre dhe praktikimi i riteve të tyre të devijuara në gjitha vendet Islame, sidomos në vendet e shenjta. Ata do të përdorin ligjet e tregtisë ndërkombëtare për të ngjallur dyshim rreth mundësisë së ekzistencës së zonës së Mekës dhe Medinës larg ndikimit të investimeve ndërkombëtare dhe me automatizëm të drejtën e jo myslimanëve për të tregtuar në ato vende. E rëndësishme është se perëndimi do t'i shfrytëzojë të gjitha ligjet ndërkombëtare, që janë formësuar për të përkrahur projektin e hegjemonisë, futjen e dilemave mes myslimanëve rreth fesë Islame dhe për të përkrahur këdo që lufton Islamin.

Çfarë duhet të bëjmë për ta përballuar këtë zhvillim?

Si e përballon umeti këtë sulm të perëndimit?

Sipas meje, ne fillimisht duhet të pranojmë se jemi para një lufte kundër fesë islame dhe myslimanëve, dhe se kjo nuk është vetëm një mospajtim kohor rreth disa çështjeve ose veprimeve. Në përballje me këtë sulm të egër, ne duhet gjithashtu të ringjallim nocionet e fesë Islame të pastër. Largimi i fesë Islame nga hapësira e ndikimit ideologjik dhe kulturor vetëm pse është i sulmuar nga perëndimi do të ishte një përfundim shumë brengosës.

Thirrësit islamë, ideologët dhe lid-

erët brenda trupit islam duhet t'i fuqizojnë nocionet Islame dhe t'i ruajnë ato nga çdo shëmtim a fshehje. Gjithashtu, është me shumë rëndësi që në etapën e ardhshme ta ruajmë umetin nga rreziku i fe-mohimit dhe nga synimi i armiqësismit të mbarë popujve të botës me fenë Islame dhe myslimanët. Kjo nuk mund të arrihet me asgjë tjetër përpos se duke i rikthyer xhamisë rolin që ka në jetën e myslimanëve dhe në qëndresën dhe zbulimin e planeve perëndimore për të përdorur Islamin kundër myslimanëve, teksa rrahin t'i ndryshojnë kuptimin teksteve fetare, largimi i disa teksteve të tjera nga debati publik dhe përqendrimi vetëm në disa nocione që e dobësojnë vullnetin e rezistencës dhe i ofrojnë mundësi suksesi hegjemonisë perëndimore kundrejt umetit.

Mbrojtja e fesë Islame, mbrojtja e rolit të xhamisë dhe mbrojtja e të drejtës së popujve të rezistojnë, do të paraqesin boshtet kryesore në projektin e përplasjes me sulmin e perëndimit kundrejt fesë Islame.

(Autori është drejtor i sektorit të studimeve dhe hulumtimeve pranë Qendrës Arabe për Studime Humane në Kairo. Studiues i cili hulumton perëndimin dhe raportin e tij me botën arabe dhe Islame. Komunikimi me autorin mund të bëhet nëpërmjet adresës elektronike personale: editor@khafagi.net ; kjo temë ishte vazhdim nga numri 53 i revistës.)

Përshtati: Bekir HALIMI

T'i gëzosh muslimanët... art i shpirtreve të bardhë

Halid Rushëh

Gëzim i papërskrueshëm kaplon zemrën e njeriut, kur ai i gëzon të tjerët, kontribuon për gëzimin e tyre ose ua lehtëson dhembjen... është gëzim që mund ta ndjejnë vetëm shpirtat e pastër si loti, të cilët vazhdimisht kanë një shpresë – të arrijnë kënaqësinë e Zotit

dhe një preokupim – të gjenden në çdo rrugë të hairit.

Kjo jetë është përplot lodhje, vështirësi, sprova, probleme e dhembje, sado që largohen ato, së shpejti kthehen në vuajtje, në asnjërën prej tyre nuk ka momente të çiltra, përpos



momenteve të adhurimit të sinqertë që bëjmë kundrejt Zotit të botëve.

Njerëzit, të gjithë njerëzit, kanë nevojë t'u shtrihet dora e mëshirës, që do t'i qetësojë në momentet e fatkeqësisë, do t'ia lehtësojë dhembjet dhe do t'ua lagë fytyrën kur ato i mbulon thatësia...

Ata që kanë përvojë më të madhe në këtë jetë e dinë bindshëm se njerëzit me nam më të madh janë ata që i këshillojnë të tjerët me dije të dobishme, ata që i shpëtojnë të tjerët nga problemet, ata që ua lehtësojnë të tjerëve vështirësitë dhe ata që japin mundin t'i gëzojnë të tjerët.

Ndalu pak, të shikojmë rastin interesant, kur njëri prej shokëve të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, thirri një mysafir që desh ta nderonte dhe t'i falte gëzim, mirëpo ushqimi s'mjaftonte, kështu që shoi qiriun dhe shtirej se është duke ngrënë derisa mysafiri e sosi ushqimin dhe u ngop. Atëherë, zbret një ajet për të regjistruar këtë ngjarje të vogël në sy të njerëzve, por e madhe në peshoren e sjelljes dhe vlerave, prandaj Allahu vlerësoi këtë në shkallë të lartë, duke thënë: *"...por duan t'u bëjnë më mirë të tjerëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë..."* (Hashër 9).

Ata i jepnin përparësi ngopjes së lukthit të mysafirit, para lukthit të tyre, ata vlerësoan më të shenjtë gëzimin e shokut sesa gëzimin e vet, dhe kështu arritën një lloj tjetër të gëzimit, i cili është më i madh dhe më i lartë...

Sa mund kishte dhënë i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, me shpresë që t'i bënte dobi njerëzve dhe t'i gëzonte ata në dynja dhe ahiret. Ajsa radijAllahu anha, rrëfen se e kishin pyetur njëherë: A falej Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, ulur ndonjëherë? Po, atëherë kur e lodhën njerëzit.

Përkujto së bashku me mua rastin e atij sahabiu që shpejtoi me tërë forcën drejt tre personave që kishin munguar nga lufta, me qëllim t'u kumtonte lajmin e gëzuar se Allahu ua kish falur gabimin e t'i mbushte ato zemra me dashuri, gëzim, lumturi dhe ngazëllim. Ai, madje, nuk duroi të arrinte tek ata, por prej së largu thërriste me tërë zërin që kishte: **O Ka'b b. Malik, myzhde...** Ka'bi rrëfen:

Menjëherë u përula në sexhde, se e kuptova që kishte ardhur rrugëdalja, ngase Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, pas namazit të sabahut kishte lajmëruar njerëzit se Allahu na ka falur gabimin dhe njerëzit me të shpejtuar vinin të na uronin, te dy shokët e mi kishte shkuar dikush tjetër, ndërsa drejt meje ish nisur me kalë njëri që para meje kishte pranuar Islamin dhe kur arriti te kodra, zëri i tij vinte më shpejtë se kali; kur dëgjova nga ai lajmin e gëzuar, hoqa rrobat e mia dhe ia dhurova atij pasi më dha myzhdenë, ndërsa nuk kisha rroba të tjera. Pas kësaj, huazova rroba dhe dola me shpresën për të takuar Resulullahun, salAllahu alejhi ue selem, ndërsa njerëzit grupe-grupe më takonin e më uronin pendimin. Kur e përshëndosha të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, fytyra e tij shkëlqente nga gëzimi dhe më tha: *"Gëzohu me këtë mirësi, që nuk të ka kapluar që nga dita kur të lindi nëna"*.

Shiko çfarë gëzimi e kaploi të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem,

dhe shokët e tij me rastin e kësaj mirësie që i ndodhi shokut të tyre, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata.

Përveç kësaj, lexo edhe këtë hadith të vërtetë, Ebu Hurejre radijAllahu anhu rrëfen se i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nga veprat që Allahu do më së shumti janë futja e gëzimit në zemrën e besimtarit, largimi i mërzisë, larja e borxhit të tij dhe t’i japë ushqim, kur ka nevojë”*. (Shënon Bejhekiu, Albani në Sulsiletu Sahiha nr. 1494 thotë se ky hadith është hasen).

Në një transmetim të Taberaniut thotë: *“Vepra më e dashur tek Allahu, pas farzeve, është futja e gëzimit te myslimani, t’ia mbulosh të metat, t’ia zbusësh urinë ose t’ia plotësosh nevojat”*.

Ai gjithashtu shënon nga Ajsha, radijAllahu anha: *“Kush fut gëzimin në një familje myslimane, Allahu do t’i japë vetëm një shpërblim: Xhenetin”*.

Po ashtu, shënuar nga Enesi: *“Kush e takon vëllanë mysliman me diç për ta gëzuar, Allahu do ta gëzojë atë në ditën e Kiametit”*.

Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush i heq myslimanit një brengë prej brengave të dynjasë, Allahu do t’i heqë atij një brengë prej brengave të Kiametit, kush ia lehtëson dikujt vështirësinë, Allahu do t’i japë lehtësime në dynja dhe ahiret. Allahu është në ndihmën e robrit, përderisa ai është në ndihmë të vëllait tij”*.

Lexues i nderuar, kjo sjellje është ibadet, nëse kemi parasysh nijetin e mirë, madje, kjo është prej punëve më të dashura tek Allahu i lartësuar... Medito, pra.

Ndërsa shoqëritë – të cilat janë

duke përjetuar konfliktet e shumta për interesa personale – janë të varfra për ta kuptuar këtë madhështi, e cila këlthet drejt nesh: Nxitoni të silleni butë me njerëzit, t’ua hiqni atyre brengat, t’ua lehtësoni dhembjet, t’i ushqeni të uriturit, t’ua lani borxhet borxhlinjve dhe ta gëzoni të dëshpëruarin.

Kur vetë thirrësit të mësojnë madhësinë e futjes së gëzimit te myslimani dhe të punojnë sipas saj, atëherë do të japin një shëmbëlltyrë të gjallë në një shoqëri që e kemi humbur prej disa kohësh.

Sa të lartë ishin ata njerëz të mirë, me shpirtra të bardhë, që vazhdimisht punonin për t’i gëzuar vëllezërit e tyre, pyesnin për hallet e tyre dhe kontribuonin për ta ndihmuar të dëshpëruarin, për ta shëruar të sëmurin dhe për t’ua zgjidhur problemet, pavarësisht çka u kushtonte kjo gjë: lodhje fizike, harxhim pasurish apo harxhim kohe. Të gjitha këto, me shpresë që të fitonin buzëqeshjen e të dëshpëruarit, e cila i gëzonte pamasë, dhe të hynte në listën e veprave të mira për Ditën e Takimit.

Sa mund kishte dhënë i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, me shpresë që t’i bënte dobi njerëzve dhe t’i gëzonte ata në dynja dhe ahiret. Ajsha radijAllahu anha, rrëfen se e kishin pyetur njëherë: A falej Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, ulur ndonjëherë? Po, atëherë kur e lodhën njerëzit. (Muslimi).

ElKasimi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Plotësimi i nevojave dhe bërja e tyre pa ndonjë lutje është detyrë për vëllezërit, madje, ato kanë përparësi përpara nevojave personale. Kjo është*

shkallë-shkallë, më e ulëta është: Plotësimi i nevojës së dikujt pasi të lut (kërkon) ai, mirëpo duke qenë fytyrëçelur, fytyrëqeshur dhe i gëzuar. Disa kanë thënë: Nëse kërkon nga vëllai që ta kryejë një punë dhe ai nuk e bën, përkujtoja sërish se ndoshta ka harruar, nëse tani nuk e kryen atëherë falja xhenazen dhe lexoje ajetin: **“...ndërsa të vdekurit, Allahu i ngjall”**. Kishte prej gjeneratave të para, njerëz që interesoheshin për hallet e familjeve të shokëve deri në dyzet vjet pas vdekjes së shokut, shkonin çdo ditë për të shikuar nevojat e tyre dhe për t’u dhënë nga pasuria personale. Pra, mund të thuhet se ajo familje humbiste vetëm trupin e babait, madje, nga shoku i babait arrinin gjëra që nuk i arrinin sa ishte babai gjallë. Kishte prej tyre që vinin te shtëpia e tjetrit, ua kryenin nevojat pa u vënë re nga shoku nevojtar, atëbotë ishte e dukshme dhembshuria dhe vëllazëria, ngaqë dhembshuria jote, nëse nuk arrin të ndjehet edhe me problemet e vëllait tënd, atëherë s’ka hair në atë dhembshuri. Mejmun b. Mehrani kishte thënë: “Nëse shoqërimi me dikë nuk të bën dobi, atëherë s’humbet asgjë edhe nëse armiqësohesh me të”. Pra, nevoja e vëllait tënd për ty duhet të jetë sikur nevoja jote, madje, edhe më e rëndësishme. Duhet të interesohesh kur ai ka nevojë dhe jo të tregohesh pavramendas për hallet e tij, siç interesohesh për hallet tua e jo ta detyrosh që ai të kërkojë ndihmë prej teje. Po ashtu, mos mendo se ai të ka ndonjë hak ty pse i ke kryer një problem, përkundrazi të ndjehesh mirë pse ka pranuar ndihmën dhe kontributin

tënd”. (Tehdhibu meu’idhatil mu’minin).

E kanë pyetur Imam Malikon: Cilën vepër do? “T’i gëzoj myslimanët, unë kam dhuruar veten në shërbim për të larguar brengat e myslimanëve” – ishte përgjigjur.

Ebu Seidi, Allahu qoftë i kënaqur me të, rrëfen: “Gjatë një udhëtimi me të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, erdhi një njeri me një kafshë të tij e filloi të lëshojë shikimin djathtas-majtas (mos vallë do ta ndihmonte kush), ndërsa Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, tha: *“Kush ka kafshë tepër, le t’ia japë atij që nuk ka, kush ka nozull më shumë, le t’i japë atij që nuk ka”* dhe përmendi disa lloj pasurish saqë u bindëm se nuk kemi hak në pasurinë shtesë”. (Muslimi 3258).

Njeriut të mirë nuk i fshihen metodat e futjes së gëzimit te vëllai mysliman. Ai e përgëzon me myzhde, i tregon lajmet e mira që i priste, ia lan borxhin, i jep dhurata, ia shpreh dashurinë që ka kundrejt tij për hir të Allahut, tregon bujarinë ndaj familjes së vëllait, fëmijëve apo shokëve të tij, ia mëson ndonjë dije të dobishme, e nderon në mesin e të tjerëve, nxiton t’ia plotësojë dëshirat çdoherë, e këshillon me të mirë në të mirë si dhe shumë metoda tjera, që dihen dhe janë të njohura, por kjo është vetëm përkujtim. Madje, mund ta gëzosh vëllain mysliman duke thënë vetëm një fjalë të vetme mirësie, duke bërë një buzëqeshje të sinqertë ose duke e përshëndetur për dore ngrohtësisht. Medito, pra.

nga arabishtja:
Omer BERISHA



Mirësjellja ndaj Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, (2/2)

shkruan: Ulvi FEJZULLAHU

Mirësjellja ndaj të dërguarit të Allahut të Lartësuar, Muhamedit, salAllahu alejhi ue selem, mund të shpjegohet në tre nivele, të cilat janë:

E para: mirësjellja me shpirt (zemër);

E dyta: mirësjellja me fjalë;

E treta: mirësjellja me vepër.

Në vazhdim do të flasim për nivelin e dytë.

Mirësjellja me fjalë.

Mirësjellja - nocion kuptim gjerë, që ngërthen në vetvete forma, trajta,

imazhe, modele të llojllojta. Në këtë nivel bëhet fjalë për të shprehurit me gjuhë, pra, atë çka përfaqëson gjuha.

Gjuha si mjet që i shërben myslimanit për të kumtuar mendimet është dëftues dhe referencë e zemrës. Me anë të artit gojor arrihet komunikimi i ndërsjellët mes njerëzve dhe përm-bushet thirrja (mesazhi) Islame. Vaditja në gojëtarin është domosdoshmëri për artikullimin e drejt dhe të qartë të karakterit të së vërtetës Hyjnore. Kujtojmë fjalët e Musait, alejhis selam, kur iu lut Allahut të Lartësuar për largimin e mangësisë gojore në të shprehur: *“Dhe zgjidhja nyjën nga*

Artikuj

gjuha (ma largo mangësinë e të shprehurit). ***Që ata ta kuptojnë fjalën time.*** (Taha 27-28) ***“Dhe vëllain tim Harunin ai është më i gojës dhe më i shprehur se sa unë; dërgoje pra edhe atë me mua si ndihmues për të më vërtetuar mua.”*** (Kasas 34).

Të folurit bukur është atribut i krijesës njeri, dhuratë nga Allahu i Lartësuar: “I Gjithëmëshirshmi (Allahu)! Ai ua mësoi (juve njerëz) Kur’anin. Ai krijoi njeriun. Ai i mësoi atij të folurit e bukur (e të shprehurit).” (Rahman 1-4).

Atëherë, myslimani si duhet ta shpalosë mirësjelljen me fjalë ndaj të Dërguarit të Allahut të Lartësuar!?

Mirësjellja gojore me Muhamedin, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, është një standardizim me përmasa dhe cilësi të caktuara.

Komunikimi gojor me të Dërguarin e Allahut është shumë me rëndësi, peshë e saj shihet edhe në ajetin 2 dhe 4 të sures “Huxhurat”. Allahu i Lartësuar thotë: ***“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj përmbi zërin e Pejgamberit, as mos i flisni atij në bisedë me zë të lartë siç flisni me njëri-tjetrin, e të zhduken veprat tuaja duke mos e ditur ju.”*** (Huxhurat 2) ***“Vërtet se ata që të thërrasin ty (O Muhamed) përtej mureve, shumica e tyre nuk gjykojnë.”*** (huxhurat 4). Nga këto dy ajete mësojmë dy çështje me rëndësi:

E para: Uljen e zërit (mos ngritjen) në praninë e Muhamedit (lavdërimi

“Kush jeni ju dhe nga jeni? Thanë: Ne jemi nga Taifi. (Omeri) tha: Po të ishit nga qyteti jonë, do t’ju kisha ndëshkuar, për arsye të ngritjes së zërit në xhamin e të Dërguarit të Allahut.”

dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Muhamedi (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) burim i Islamit, ai kumtoi fjalën e Allahut, Kur’anin dhe la në trashëgimi Synetin. Myslimanët duhet të tregojnë mirësjellje ndaj trashëgimisë profetike. Një kërkesë e tillë vjen edhe nga Allahu i

Lartësuar, ku i mëson besimtarët që të mos ngrenë zërin përmbi zërin e Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe nuk lejohet që biseda më atë të jetë me ton të lartë. Pjesë e respektimit ndaj të dërguarit të Allahut është edhe mënyra e bisedës dhe komunikimit duke zgjedhur theksin e tonin e këndshëm, të butë e të ëmbël. Një gjë e tillë e kërkoi Allahu i Lartësuar prej shokëve të tij, të kenë një mënyrë të veçantë komunikimi me Muhamedin (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Allahu i Lartësuar i bën thirrje myslimanëve të tregojnë mirësjellje ndaj pejgamberit të tyre, përndryshe veprat e besimtarëve do të asgjësohen. Sepse paedukata ndaj pejgamberit është shkaktare e asgjësimit të veprave, duke iu pakësuar vlera veprave të mira. Po ashtu, duhet të kujtojmë se ajo që lëndon, dëmton dhe cenon të dërguarin e Allahut konsiderohet një prej mëkateve të mëdha dhe mund të rrëshqasë edhe në mosbesim (kufër). Sahabët e Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ta) i kushtuan kujdes të veçantë dhe fituan lavdërimin e Allahut të Lartësuar: ***“Vërtet se ata të cilët e ulin zërin e tyre***

në prani të të Dërguarit të Allahut, ata janë të atillë, zemrat e të cilëve Allahu i ka provuar për frikë dhe përkushtim ndaj Allahut. Për ta ka falje dhe shpërblim të madh.” (Huxhurat 3).

Kjo ishte për sahabët që jetuan me pejgamberin e Allahut, kurse edhe pas vdekjes së tij myslimanët e kanë për obligim që mos të ngrenë dhe lartësojnë zërin kur dëgjojnë hadithet, Syneket, sepse trashëgimia profetike është në jetë dhe e pranishme deri në fundin e kësaj bote. Ibën el-Arabiu (Allahu e mëshiroftë) thotë: “I dërguari i Allahut është i shenjtëruar edhe pas vdekjes, ashtu si ishte i shenjtë kur ishte në jetë, edhe fjalët e tij pas vdekjes janë të ndershme dhe të respektuara sikur të dëgjohen drejtpërdrejt nga goja e tij. Kur lexohen fjalët e Profetit është detyrë (vaxhib) çdo kush që është prezent mos të ngrejë zërin, ashtu siç nuk lejohej të veprohet në prezencën e tij. Për vazhdueshmërinë e shenjtërimit të Muhamedit gjatë kohërave paralamëroi Allahu i Lartësuar duke thënë: **“Dhe kur të lexohet Kur’ani, dëgjoheni atë me vëmendje dhe heshtni, që të mund të fitoni mëshirë e të mëshiroheni.”** (Araf 204). Po edhe fjalët e Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) janë shpallje dhe janë të shenjta sikundërse edhe Kur’ani.” Po ashtu, duhet të tregohet kujdes edhe në xhaminë e Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), nuk duhet të ngrihet zëri, me këtë rast veçojmë rastin e dy vetave kur hynë në xhami dhe më pas i pyeti Omeri: “Kush jeni ju dhe nga jeni? Thanë: Ne jemi nga Taifi. (Omeri) tha: Po të ishit nga qyteti jonë, do t’ju kisha ndëshkuar, për arsye të ngritjes së zërit

në xhaminë e të Dërguarit të Allahut.” (Buhariu)

E dyta: Përdorimi i thirrjes që është në përputhje me dinjitetin dhe titullin e të dërguarit të Allahut të Lartësuar. Gjithashtu, edhe thirrja është një mënyrë me të cilën i drejtohesh dikujt, dhe kjo lë gjurmë te personi që thirret. Në kuadër të edukatës dhe mirësjelljes me fjalë ndaj Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) tërheq vëmendjen e sahabëve Allahu i Lartësuar në Kur’an, duke kërkuar që thirrja e drejtuar ndaj të Dërguarit të Allahut të jetë në përputhje me titullin e tij. Allahu i Lartësuar i tha Muhamedit salallahu alejhi ue selem: **“Vërtet se ata që të thërrasin ty (O Muhamed) përtej mureve, shumica e tyre nuk gjykojnë.”** Rasti është me një sahab; kur shkoi në shtëpinë e Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe i tha: O Muhamed dil! Dhe ai nuk doli. Nga ajeti në fjalë sahabët mësuam se i Dërguari i Allahut nuk duhet të shqetësohet kur ai është në shtëpi dhe t’i drejtohet atij me shprehje thirrrore. Po ashtu, nga ajeti në vijim sahabët marrin udhëzimin edukativ që të jenë të durueshëm në pritje deri sa të dalë Muhamedi (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të). Allahu i Lartësuar tha: **“Dhe po të kishin durim derisa ti të dilje jashtë tek ata, do të kishte qenë më mirë për ta. Dhe Allahu është gjithnjë Falës i Madh, Mëshirëplotë.”** (Huxhurat 5) Atëherë, nga kjo që u tha deri më tani mësojmë se Muhamedi (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) nuk duhet të thirret me intonacione thirrrore, por me thirrje të buta, të qeta

dhe që janë të përshtashme me karakterin, madhësitë dhe personalitetin e një të dërguari të Allahut të Lartësuar. Si: O i Dërguar i Allahut! O Pejgamber! O Mësues i njerëzimit! Ndërsa e ndaluar është të thirret: O Muhamed! O Ahmed! Allahu i Lartësuar thotë: *“Mos e bëni thirrjen ndaj të Dërguarit (Muhamed) mes jush, siç thërrisni ju njëri-tjetrin.”* (Nur 63).

Të nderuar lexues!

Një respekt dhe nder i ka bërë Allahu i Lartësuar Muhamedit (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), që e privilegjoji nga të dërguarit e tjerë dhe asnjë herë në Kur'an nuk i tha “O Muhamed”, por në raste të caktuara e thirri me këto trajta: *“O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua: “Në qoftë se dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, atëherë ejani! Unë do t’ju siguroj jetesën dhe do t’ju lë të lira me bujari (duke u ndarë).”* (Ahzab 28) *“O i Dërguar! Shpalle atë (Mesazhin) i cili të është zbritur ty nga Zoti yt.”* (Maide 67) *“O ti i mbuluar me rroba! Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj.”* (Muzzemmil 1-2).

Mëkatimi ndaj Allahut - Ademi dhe ne

Shkruan: Blerim MUHAXHERI

Ademi është njeriu i parë që Allahu e ka krijuar në fytyrën e tokës. Është një krijim i çuditshëm, mirëpo kur është në pyetje fuqia e Allahut çdo gjë është e mundur. Ai u krijua nga dheu. Ky krijim është i udhëhequr nga thënia e Allahut: “Kun – Bëhu”. Pas krijimit të Ademit, Allahu trupin e tij e gjallëroi duke e futur shpirtin në të. Urtësi dhe porosi të mëdha fshiheshin në këtë krijim, e më kryesorja prej tyre është: bëhu i qetë, i urtë, i përkulshëm dhe i dëgjueshëm sikur toka, ndërsa trupin tënd gjallëroje dhe udhëhiqe me urdhrat të cilat vijnë prej qiellit.

Allahu vendbanim ku do të jetonte Ademi ia dha xhenetin. Aty iu mundësua të jetonte së bashku me gruan e tij Havanë. Ai ishte një vend shumë i bukur. Ishte i pajisur me të gjitha të mirat me të cilat mund të kalonte një jetë të qetë e të lumtur çifti bashkëshortor. Ishte kopsht, i çili ishte i rrethuar me pemë të llojeve të ndryshme. Dhe mbi të gjitha ishte lumturia dhe kënaqësia që mbretëronte tek çifti bashkëshortor.

Mirëpo, nga e tëra kjo me të cilën ishte i



pajisur Ademi, ishte e pranishme një gjë e cila Ademin e kishte futur në provë. Në mesin e të gjitha pemëve të cilat ishin të lejueshme për të, ndodhej një pemë e cila i ndalohej.

Kjo ishte një armë e fortë për djallin, i cili filloi ta përdor menjëherë që njeriun ta nxit që të mëkaton ndaj Krijuesit. Mendjemprehtësinë filloi ta përdor menjëherë që njeriun ta fus në lojën e mëkatit. Zgjuarsinë filloi ta shprehë ndaj pemës së ndaluar. U zgjua ambicia e tij që njeriun mos ta lërë në rrugën e respektit ndaj Krijuesit. I zgjeroi rrugët e dijes me fjalët miradije që do t'ia thoshte njeriut. E përgatiti terrenin për ta realizuar qëllimin e tij. Dhe në fund aktivitetin e vet e realizoi me sukses derisa njeriun e gjuhëzoi para mëkatit.

Kjo çështje e goditi Ademin, respektivisht hapat të cilat i ndërmoi djalli për ta futur Ademin në mëkat i realizoi në mënyrë të suksesshme. E joshi Ademin

me fjalët e tij zbukuruese. E bindi me premtimet e tija të rrejshme. E habiti me garancinë të cilën ia dha, derisa në fund e përkuli para mëkatit duke e bërë të zhveshur në mesin e vendbanimit të tij.

Mirëpo, Ademi u “zgjua” menjëherë nga kjo gjendje që u gjend. U kthjell nga kjo huti që e goditi. U pendua dhe kërkoi falje për gabimin e bërë; për mosrespektimin e urdhrit të Allahut dhe për rrëshqitjen në mëkatin e bërë. Mëshira e Allahut ndaj robërve të Vet është e madhe dhe kujdesi i Tij ndaj tyre është i papërshkrueshëm; ia fali gabimin Ademit dhe ia pranoi pendimin.

Ajo që e goditi Ademin, sot është duke na goditur edhe neve. Djalli është duke përdorur mjete dhe metoda që është duke na e zbukuruar të keqen dhe po na fut rrugëve të saja. Të keqes i ka dhënë ngjyrë joshëse që është duke e tërheqë çdonjërin. Rrugët e së keqes është duke

Artikuj

i shumëzuar dhe po i le në pritë të gjithsecilit, në mënyrë që të jenë afër njeriut dhe të mos mundet që të shpëton prej tyre. Çështjen e aktivitetit ndaj së keqes është duke e rrit ndërsa kufijtë e saj dukshëm i ka zmadhuar. Është bërë thirrës në të keqën dhe largues nga e mira. Pronar i të kotës e këshillues në të dhe pengues për në rrugën e drejtë.

Pamja e njeriut të sotëm bashkëkohor po na kujton në punën e pandërprerë dhe të palodhshme që djalli po e kryen ndaj tij. E ka larguar nga rruga e vërtetë dhe e ka futur në ëndrra dhe iluzione. E ka bërë pasues të epshit dhe e ka orientuar vetëm nëpër vepra çoroditëse. Interesimin e tij e ka bërë vetëm në ato çështje që i përshtaten epshit të tij dhe që janë ngacmuese për të riun. Atë e ka futur në botën e të keqes dhe sherrit, mirëpo ia ka mbyllur të gjitha dyert që të mos mundet ta shoh realitetin e as që të kthjellët për t'u penduar nga ajo që po pason. E humbi njeriun në të kotë dhe nuk po i jep mundësi që të takohet me të Vërtetën. Po e largon njeriun sa më tepër nga Islami, ngase nuk po do ta shoh atë respektues ndaj Allahut. Ia turbulloi njeriut trurin duke ia mbushur me kotësi, me qëllim që të mos mundet të përputhet ajo me udhëzimet e Zotit. E la të varur nga shpresa të kota duke e neglizhuar nga udhëzimi. E privoi nga Kur'ani duke e lënë pa udhërrëfyes dhe e la të vetëm që të bredhë rrugëve. Tërë këtë punë dhe mundim që po e bën djalli ndaj njeriut, është vetëm me një qëllim: ta largon sa më tepër nga rruga e Allahut.

Fakt ky, sot jemi dëshmitarë të rezultateve që i ka arritur djalli prej punës së vet. Jo vetëm që e ka larguar njeriun nga e Vërteta, por e ka bërë luftues ndaj saj,

mohues të argumenteve dhe mosbindës për në rrugën e drejtë. Çështjen e Islamit nuk po e shohin ndryshe vetëm si çështje prapambetjeje dhe ngecjeje. Personalitetin e myslimanit nuk po e shohin si paqedashës dhe liridashës por si terrorist dhe fundamentalist. Çështjen e shtëpive të Zotit po e shohin si rrezik dhe po ndërmarrin masa për djegien e tyre. Mbulesa po u duket absurde e robëri dhe kinse po ndërmarrin masa për çlirimin e gruas nga robëria, kurse qëllimi i tyre është me prapavija tjera. Pra, e tërë kjo që po mbretëron është si rezultat i largimit të njeriut nga e Vërteta dhe për shkak të mospasjes mundësi (për shkak të ndikimeve të djallit) që të ushqehet me udhëzimet e të Vërtetës.

Jo vetëm kaq, mosrespektimi i urdhrit të Allahut dhe mëkatimi ndaj Tij është bërë normale, bile edhe vepër zburuese. Kjo po përcillet me anë të lakuriqësisë së gruas duke vallëzuar nëpër kënga të ndryshme apo me anë të trupit të saj si mjet reklame; pasimi i hapave të modave të huaja derisa njeriun po e nxjerr nga ai kallëp në të cilën e ka krijuar Allahu; marrja e të rinjve me vepra shfrenimi dhe degenerimi derisa iu dha një ngjyrë nënçmimi dhe turpi; vrapimi pas vajzave të reja dhe kontaktet e fëlliqura me to derisa nderin e bëri të panjohur për ne...

Çështja e mosrespektimit nuk mbeti vetëm me kaq, por i zgjeroi kufijtë e saj edhe më tutje. Filloi të shfaqet me vepra që vërtet janë shqetësuese dhe brenghënëse për myslimanin. Vepra që, jo vetëm që mohohet e Vërteta dhe nënçmohet personaliteti, por edhe bëhet tallje me të. Kjo është vepra e njerëzve të humbur të Danimarkës. Të cilët pa

fije turpi dhe mareje bënë karikatura me personalitetin e të Dërguarit. Tërë këtë aktivitet duke e bërë nën moton “liria e të shprehurit”. Zgjerimi i kësaj nëpër media askujt nuk i pengoi dhe nuk ia vrau syrin.

Pra, nga e tërë kjo që e thamë, na bëhet me dije se kjo çështje në kohën që jemi duke jetuar, pra në kohën bashkëkohore është duke marrë hov të madh dhe përmasa të gjëra. Çdo gjë që po ndërmerret është në mosrespektim të Allahut dhe në thyerjen e urdhrit të Tij. Por, ajo që na brengos dhe e bën faktin e habitshëm është se, përveç se të huajt që janë ngritur edhe ne po marrim pjesë në këto vepra, në to po marrin pjesë edhe disa prej nesh, të cilët së bashku me të huajt janë bërë bashkëpunëtorë në këto aktivitete.

Pasi që Ademi gaboi ndaj Allahut dhe e theu urdhrin e Tij, ai menjëherë u pendua. Kurse ne, jo që nuk pendohemi por as që e vrasim mendjen në atë se kemi thyer ndonjë urdhër të Allahut. Si rezultat i kësaj, Ademiti iu pranua pendimi dhe u bë i pastër, kurse ne mbetëm të zhytur në mëkate dhe të ngjyrosur me njolla të zeza si pasojë e punëve të këqija që po bëjmë.

Na mbetet që ta psojmë rrugën e Ademiti dhe të pendohemi se përndryshe...



Në rrugë... sprovat

Muhamed Husejn JAKUB

Kushdo që jeton, përballet patjetër me shenjat e ndalimit. Kjo jetë është me valë të llojllojta me të cilat përballet njeriu. Këto pengesa janë shenja korrigjuese dhe reformuese.

Artikuj

I Lartësuar Allah na thotë: *“Mjaft shembuj të ngjashëm patën përballë kombet që kanë kaluar përpara jush. Udhëtoni pra nëpër botë dhe shihni fundin e atyre që mohuan. Ky (Kur'an) është fjalë e qartë për njerëzimin, udhëheqje dhe këshillë për të devotshmit. Kështu pra, as mos u ligështoni, as mos u dëshpëroni dhe do të jeni fitimtarë, në qoftë se me të vërtetë jeni besimtarë. Nëse ju prek ndonjë plagë, të jeni të sigurt se e njëjta plagë ka prekur edhe të tjerët. Kështu janë edhe ditët (të mira dhe jo aq të mira), të cilat Ne ua çojmë njerëzve me radhë, që Allahu të mund t'i provojë ata që besojnë dhe që Ai të mund të marrë shehida nga mesi juaj. Dhe Allahu nuk i do zullumqarët. Dhe që Allahu të mund t'i pastrojë besimtarët dhe t'i shkatërrojë mosbesimtarët. A mos mendoni se do të hyni në Xhenet, përpara se Allahu t'i sprovtojë ata të cilët luftuan nga mesi juaj si edhe t'i sprovtojë ata që janë të durueshëm?”* (Ali Imran 137-142)

Këto ajete tregojnë se Allahu i Lartësuar bën ndërrimin e ditëve në njerëz (në epërsi apo humbje), duke testuar gjendjet e tyre. E gjithë kjo ndodh për arsyen e ngritjes së dëshmisë mbi robërit (e Allahut), se kush e meriton Xhenetin dhe kush nuk e meriton. Shtegtuesit për tek Allahu korrigjohen, por: *“Allahu nuk do t'i lërë besimtarët në këtë gjendje që*

Pa dyshim që njeriu furnizohet me pasuri dhe ai mendon që kjo është begati, por kjo pasuri për të është sprovë. Mund që njeriu të fitojë një pozitë (detyrë) dhe tek të tjerët kjo llogarit si privilegj, ndërsa për vetë personin është fatkeqësi.

janë tash, por derisa Ai të veçojë të ligën nga e mira dhe as nuk do t'ju zbulojë juve sekretet e Gajbit (e të fshehtës), por Allahu zgjedh nga të Dërguarit e Tij atë që Ai dëshiron. Besoni pra në Allahun dhe në të Dërguarit e Tij. Dhe në qoftë se besoni dhe e keni frikë Allahun, atëherë për ju do të ketë shpërblim të madh.” (Ali Imran 179).

Të nderuar vëllezër!

Është me rëndësi të bëhet dallimi mes begatisë, dënimit dhe sprovës. Po ashtu, (të bëhet dallimi) mes dhuntisë dhe fatkeqësisë, si dhe mes vështirësisë dhe lirisë.

Gjatë rrugës për të arritur deri tek Allahu, besimtari duhet patjetër të dallojë begatinë dhe sprovën. Kështu që dy vetë mund ta zotërojnë një dhunti, por për njërin është begati, ndërsa për tjetrin është sprovë.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Ose (Shembulli i tyre është) si ndonjë shi i rreptë prej së larti me errësirë, me bubullimë e me vetëtimë.”* (Bekare 19).

Fjala “shi i rreptë” është “uji” që gjallëron tokën, por në të njëjtën kohë (shiu) përcillet edhe “me errësirë, me bubullimë e me vetëtimë.”

“Ata i rrasin gishtërinjtë në veshë për të mos dëgjuar ushtimën tmerruese (këtë e bëjnë) nga frika e vdekjes.” (Bekare 19)

Dijetarët thanë: Ky ngjasim i ujit i përshkruar nga Allahu i Lartësuar në

Kur'an është shiu i stuhishëm që është për besimtarët. Thotë i Lartësuar: ***“Ne të shpallëm Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshpërimit.”*** (Isra 82)

Pa dyshim që njeriu furnizohet me pasuri dhe ai mendon që kjo është begati, por kjo pasuri për të është sprovë. Mund që njeriu të fitojë një pozitë (detyrë) dhe tek të tjerët kjo llogaritet si privilegj, ndërsa për vetë personin është fatkeqësi. Nxënia e Kur'anit është argument për besimtarin, por mund të jetë edhe argument kundër tij.

Dijetarët kanë thënë: “nëse e sheh që Allahu po i jep njeriut përkundër mëkateve të tij, dije se për të do të jetë ndëshkimi dalëngadalë.” I bën mëkat Allahut, Ai ia shton të mirat, dhuntitë, bereqetin etj. Atëherë, padyshim që do ta kaplojë dënimi. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Ne do t'i afrojmë ata dalëngadalë te dënimi prej nga nuk e dinë. Dhe atyre Unë u jap afat, sepse ndëshkimi Im është shumë i fortë.”*** (Kalem 44-45)

Allahu i Lartësuar u jep afat zulumqarëve, kjo është prej ligjeve të Tij, por kur t'i kaplojë dënimi, asnjë nga të padrejtët nuk mund t'i shpëtojë ndëshkimit të Krijuesit Fuqiplotë.

I nderuari vëlla!

Mos u gëzo kur të shtohen të mirat, kur ti i bën mëkat Krijuesin tënd.

Bëhu prej atyre që e dallojnë dhuntinë nga sprova, kështu që: ***“Mos të dëshpëroheni tepër për atë që ju ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë.”***

(Hadid 23)

Gruaja e Sa'd b. Amir Xhumehiut thotë: Një ditë më zgjoi nga gjumi zëri i lartë i burrit duke thënë: Kërkoj mbrojtje nga Allahu prej teje! Kërkoj mbrojtje nga Allahu prej teje! Kërkoj mbrojtje nga Allahu prej teje!

Ndërsa ai në dorë kishte disa para dhe i shtynte me dorë si të ish ndonjë akrep. I thashë: Pse po vepron kështu! Më tha: “Më ka hyrë brenda (në zemër) dynjaja, do të ma lëndojë fenë.”

Po, i nderuari vëlla!

Duhet patjetër të kesh mençuri dhe ta dallos atë që të bën dobi prej asaj që të dëmton ahiretin. Kur Allahu i Lartësuar të ka dhuruar të mira dhe ti i ke shfrytëzuar në kënaqësinë e tij, atëherë kjo është begati, por nëse i ke shfrytëzuar në mëkate, atëherë këto të mira janë sprovë dhe ndëshkim. Allahu të ka dhuruar pasuri, por ajo a të ka ofruar afër Allahut apo të ka larguar prej Tij.

Mendo o vëlla!

Çdo herë në jetën tënde shiko në të mirat e Allahut dhe shih ku e ke hedhur këmbën, të mësosh se ku je. A je në rrugën e drejtë apo i humbur në rrugica? Edhe një herë, dalloje begatinë prej sprovës, dhuntinë prej ndëshkimit!

***Përshtati nga arabishtja
Ulvi FEJZULLAHU***

Artikuj



Fuqia e argumentit 2/2

Abdulmuhsin elABBAD

Rrezikun nga ekstremizmi dhe teprimi në çështjet e fesë dhe nga largimi i parimeve të ehli Synetit na e ka treguar shumë bukur i Dërguari i Allahut në hadithin vijues: “Gjëja që më frikëson më tepër për ju është njeriu që lexon Kur’an, dhe pasi në fytyrën e tij fil-lon të shihet bukuria e Kur’anit, e hedh pas shpine librin e Allahut dhe nuk i për-

fill çështjet e Islamit. Sulmon fqinjin me shpatë, e akuzon me mosbesim (e shpall qafir). Thashë: O i Dërguari i Allahut, kush prej tyre më tepër meriton të shpal-let si qafir akuzuesi apo i akuzuari. Akuzuesi - u përgjigj”. Buhariu në Tarih, Ebu Ja’la, Ibën Hibbani, El Bezzari shih. Silsiletul ehadith es-sahiha nr.3201

Nuk ka dyshim se koha e rinisë

është koha më e rrezikshme që mund të shfrytëzohet nga shejtani në kuptimin e gabuar të çështjeve të fesë. Për këtë shkak, theksojmë edhe një herë se kthimi tek dijetarët është garanci për njeriun që të ruhet nga lajthitja. Këtu sigurisht e kemi fjalën për dijetarët e sinkertë dhe besnikë. Xhundub . Abdullahi, radijAllahu anhu, thotë: Gjëja e parë që priset tek njeriu është barku i tij, pra, nëse ke mundësi që të mos hash përpos hallallit, bëje atë dhe mos lejo që pengesa mes teje dhe xhenetit të jetë një grusht gjaku që ke derdhur. Buhari (7152) Ibën Haxheri komentuesi i librit të Buhariut thotë: Kjo fjali është transmetuar edhe si hadith i të Dërguarit, salallahu alejhi ve selem, në librin e Taberaniut: E dini se unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, të thotë: *"Mos lejoni që mes juve dhe xhenetit, të cilin do ta shihni, të pengojë një grusht gjaku i myslimanit që e keni derdhur padrejtësisht"*; edhe pse në librin e Buhariut nuk është shprehur në mënyrë të hapur si fjalë e të Dërguarit, e ka të njëjtën shkallë sepse është prej gjërave që s'thuhet nga marramendja. Ky hadith është kërcënim prej Allahut për ata që vrasin myslimanë padrejtësisht. Fet'hul Bari (13/130). I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thotë: *"Ai që del prej Umetit tim dhe i vret të mirët e të këqijtë, nuk ruhet nga derdhja e gjakut të besimtarit dhe nuk e çon në vend marrëveshjen nuk është prej*

"Mos lejoni që mes juve dhe xhenetit, të cilin do ta shihni, të pengojë një grusht gjaku i myslimanit që e keni derdhur padrejtësisht"

meje dhe unë nuk jam prej tij." Muslim (1848)

Tani do të cekim disa hadithe që nuk janë në Buhari dhe Muslim, por i ka përmblledhur Mundhiri në librin Et-Tergib uet-Terhib (Inkurajimi dhe Kërcënimi – i botuar nga sh.b. Gjurma) dhe i ka vlerësuar

si të saktë Albani në librin Sahihut-Tergibi vet-Terhib (1/629-634)

ElBerau, radijAllahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Me të vërtetë zhdukja e dynjasë është më e lehtë për Allahun sesa vrasja padrejtësisht e besimtarit (mu'minit), nëse në vrasjen e tij do të kishin marrë pjesë banorët e qiejve dhe të tokës, Allahu do t'i dënonte me zjarrin e xhehenemit."* Në një hadith tjetër, të cilin e transmeton Abdullah b. Amër b. As, radijAllahu anhum, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, thotë: *"Me të vërtetë zhdukja e dynjasë është më e lehtë për Allahun sesa vrasja e njeriut mysliman."*

"Vrasja e mu'minit është më e madhe tek Allahu se sa zhdukja e dynjasë." Hadithe me këtë kuptim kanë transmetuar Ebu Se'idi, Ebu Hurejreja dhe Ebu Bekrete, radijAllahu anhum.

Muaviju, radijAllahu anhu, thotë: I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Për çdo mëkat ka shpresë se Allahu, subhanehu ve teala, do ta falë, përpos njeriut që ka vdekur si mos-besimtar dhe njeriut që ka vrarë besimtarin qëllimisht."* Të njëjtin hadith e ka transmetuar Ebu Derda, radijAllahu anhu.

Prej Ebu Musait, radijAllahu anhu, transmetohet se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Në mëngjes, Iblisi i dërgon ushtritë e tij dhe u thotë: Kush do të dëshpërojë sot një mysliman do t’i vë kurorë. Kur të kthehen, i pari do të thotë: nuk u largova derisa u nda prej gruas së tij. Iblisi do të përgjigjet: s’ke bërë asgjë, ai do të martohet përsëri. I dyti do t’i thotë: nuk u largova derisa shfaq mosbindje ndaj prindërve të tij. Iblisi do t’i përgjigjet: S’ke bërë asgjë, së shpejti ai përsëri do t’i respektojë. I treti do t’i thotë: nuk u largova derisa bëri shirk. Iblisi do t’i përgjigjet: Ti je ai, ti je ai. I katërti do t’i thotë: nuk u largova derisa vrau një njeri. Iblisi do t’i përgjigjet: Ti je ai, ti je ai, dhe do ta kurorëzojë”.

Në hadithin e transmetuar nga Ubade b. Samit thuhet: “Kush e vret besimtarin dhe gëzohet me vrasjen e tij Allahu prej tij s’do të pranojë asnjë punë.” Halid b. Dehkani thotë: E pyeta Jahja b. Jahja ElGassaniun: ç’do të thotë fjala gëzohet me vrasjen e tij? Ata që luftojnë kur gjërat janë të paqarta dhe vritet njeriu dhe tjetri mendon se e ka vrarë me të drejtë dhe nuk pendohet.

Ebu Se’id eElHudriu rrëfen: I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Prej zjarrit të xhehenemit do të dalë një qafë dhe do të thotë: Më janë besuar tre veta: çdo kundërshtar kryelartë, ai që Allahut i ka përshkruar shok dhe ai që ka vrarë një njeri pa të drejtë. Do t’i rrethojë dhe do t’i hedhë në thellësinë e xhehenemit.”

Mos i përgjakni dhe fëlliqni duart tuaja me gjakun e ndaluar dhe pasurinë e mbrojtur. Ruhuni nga zjarri, lënda e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është gati për mosbesimtarët.

Për sa i përket atij që e ka vrarë besimtarin gabimisht, për të është parashikuar pagesa e gjakut (dije) dhe shpagimi (kefaret). Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Asnjë besimtar nuk i është lejuar të mbyjë besimtarin tjetër, përpos gabimisht. E kush e

mbytë gabimisht një besimtar, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtarë dhe shpagimin (e gjakut) t’ia dorëzojë familjes së tij, përpos në qoftë se ia falin (gjakun familja). Në qoftë se ai (i mbyturi gabimisht) është besimtarë, por i takon popullit që është armik i juaji, atëherë është obligim vetëm lirimi i një robi besimtar... e kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjëroj dy muaj rresht, si pendim (i pranuar) ndaj Allahut. Allahu është më i dijsلمي, ligjdhënësi më i drejtë.” Nisa, 92

Mbi vrasjen e mosbesimtarit, gjaku i të cilit është i mbrojtur qëllimisht ose gabimisht

Vrasja e mosbesimtarit që është nën mbrojtjen e shtetit islam (dhim-mij), atij që ka hyrë në marrëveshje (muahed) dhe e atij, siguria e të cilit është garantuar (muste’men) është HARAM. Për vrasjen e tyre ekziston kërcënim me dënim prej Allahut, subhanehu ve teala.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi

ue selem, thotë: *“Ai që vret njeriun për të cilin vlen marrëveshja, nuk do të nuhasë aromën (erën) e xhenetit, që ndihet prej largësisë dyzet vjeçare.”* Buhari (3166).

Ibën Haxheri thotë: Muahed është çdo njeri që ka marrëveshje me myslimanët, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për marrëveshjen e dhënies së xhizjes, armëpushim apo garanci prej ndonjë besimtarit. Fet’hul Bari (12/259)

“Ai që vret dhimmijun (njeriun mosbesimtar që shtetit Islam i paguan xhizje), s’do të nuhasë aromën e xhenetit, e cila ndihet prej largësisë dyzet vjeçare.” Nesai - 4750 Në një transmetim tjetër të Nesaiut 4749 thuhet: *“Ai që vret dhimmijun (njeriun mosbesimtar që shtetit Islam i paguan xhizje), nuk do të nuhasë aromën e xhenetit e cila ndihet prej largësisë shtatëdhjetë vjeçare.”*

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, gjithashtu thotë: *“Ai që vret njeriun për të cilin vlen marrëveshja në kohë kur vrasja e tij është e ndaluar Allahu ia ka ndaluar hyrjen në xhenet.”* Ebu Davud (2760) dhe Nesai (4747) me sened të saktë. Në transmetimin e Nesaiut ka shtojcë: *“...dhe të nuhasë aromën e xhenetit.”*

Ibën Hibbani transmeton të njëjtin hadith me ndryshimin: *“aroma e të cilit ndihet prej largësisë njëqind vjeçare”* (Sahihut-Tergibi vet-Terhib 2/635).

Për vrasjen gabimisht të njeriut për të cilin vlen marrëveshja, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: ***“Në qoftë se ai (i vrari) është nga ai popull me të cilin keni marrëveshjen, atëherë është obligim shpagimi i (gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E***

kush s’ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjërojë dy muaj rresht, si pendim (i pranuar) ndaj Allahut. Allahu është më i dijsmë, ligjdhënës i drejtë.” (Nisa, 92).

Në fund ju them: E dashura rini, kini frikë Allahun dhe mos u bëni gjah i shejtanit e që Allahu t’ju dënojë me poshtërim në dynja dhe dënim të dhembshëm në ahiret. Mos i përgjakni dhe fëlliqni duart tuaja me gjakun e ndaluar dhe pasurinë e mbrojtur. Ruhuni nga zjarri, lënda e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është gati për mosbesimtarët. Dhe kujtojeni atë ditë të kthimit tek Allahu. Çdo njeriu i plotësohet ajo që ka fituar, dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë. Ditën kur çdo njeri do ta gjejë pranë vetes atë që veproi mirë ose keq, e për atë të keqe që bëri, do të dëshirojë që mes tij dhe asaj të jetë një distancë shumë e madhe (e mos ta shohë). Allahu u jep të frikësohen prej dënimit që vjen prej Tij. Atë ditë njeriu do të ikë prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve ... në Atë ditë secilit do t’i mjaftoj çështja e vet.

Zgjoju o rini nga shkujdesi dhe pavramendja. Mos lejo që shejtani të përdorë si mjet për të përhapur çrregullime në tokë.

Allahun e lus që myslimanëve t’u mundësojë kuptimin e saktë të fesë, që t’i mbrojë nga sprovat lajthitëse, nga ato që shihen dhe nga të fshehtat. Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij dhe mbi gjithë shokët e tij.


Letër tregtarit

shkruan: Alaudin Abazi

Sigurimi i jetës dhe fitimi i mjeteve për jetesën është një nga gjërat më të rëndësishme në të cilën na nxit feja jonë e pastër. Allahu i Lartësuar thotë: *“Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim”* (Nebe`ë, 11). Gjithashtu, thotë: *“Ai (Allahu) e diti se nga ju do të ketë të sëmure dhe të tjerë që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar begatit e Allahut dhe të tjerë që do të luftojnë në rrugën e Allahut”* (Muzemil 20)

Tregtia është një nga profesionet më të hershme të

njeriut, një nga mjetet për të siguruar jetesën. Në Islam, tregtia shihet si forma më e mirë e fitimit; dijetarët Islamë nënvijëzojnë se është rruga kryesore në sigurimin e të ardhurave.



Nga ana tjetër, Islami është fe e drejtësisë, mëshirës, tolerancës, çiltërsisë, besnikërisë, këshillimit, nderit, veçori këto që te myslimani nuk vërehen përpos se gjatë punës dhe raporteve me të tjerët.

Kështu që, te myslimani, nëse një raport pune me njerëzit shpalolet me arrogancë, padrejtësi, gënjeshtër, tradhti, ligësi, dhe zili, atëherë ai gjendet larg çdo forme të Islamit. Një njeri i këtillë është mëkatar, ngrënës i pasurisë së të tjerëve pa të drejtë dhe, si i tillë, është i zhytur kokë e këmbë në mëkate. Sa herë që në marrëdhëniet tregtare sundon shpirti Islam, përhapet dashuria, vëllazëria, bashkëpunimi mes tyre dhe mëshira e Allahut i kaplon, prej nga edhe vjen begatia nëpër shtëpitë e tyre dhe ata do të jetojnë në qetësi, paqe dhe siguri.

Prandaj, tregtarët është e domosdoshme të kenë parasysh dispozitat dhe këshillat të cilave duhet t'u përmbahen gjatë marrëdhënive me njerëzit, pastaj të njihen edhe me gjërat e ndaluara, nga të cilat duhet të largohen, duke shpalosur kështu gjatë punës së tyre moralin e lartë Islam.

Në këtë shkrim jemi munduar të parashtrojmë sa më përmbledhtas disa nga rregullat më të rëndësishme që tregtari mysliman duhet të ketë parasysh gjatë punës së tij. Gjithashtu, kemi përmendur edhe ndalesat më të përhapura në të cilat bien shpeshherë syresh, ndoshta edhe pavetëdije. Jemi munduar t'i cekim në formë të përgjithësuar, duke

iu larguar zgjerimit, lusim Allahun e Lartësuar të na bëjë nga ata që e kuptojnë të saktën dhe kapen për të dhe kuptojnë të kotën dhe largohen nga ajo.

1. Ruajtja e nderit:

Gjatë tregtisë, besimtari mysliman duhet të synojë nderimin dhe respektimin e vetvetes; nëpërmjet pasurisë së fituar duhet të përmbushë urdhrat e Allahut, të mbrojë fëmijët dhe familjen nga nevoja dhe lëmosha. Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem) thotë: *“Që ndonjëri prej jush ta marrë litarin dhe të mbledhë dru dhe t'i vejë në shpinë, është më mirë për të sesa të shkojë te dikush që Allahu i ka dhënë pasuri dhe të kërkojë lëmosh nga ai, i dha ai apo jo”* (Shënon Buhariu dhe Muslimi).

2. Tregtari i singertë:

Singeriteti është kulmi i vlerave të larta dhe themeli i çdo raporti të mirëfilltë njerëzor, çka te tregtarët dhe shitësit është shpeshherë e vështirë ta qokësh. Muhamedi (lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të) thotë: *“Tregtari i singertë dhe besnik do të jetë në xhenet, nën shoqërinë e pejgamberëve, sidik-inëve (të singertit) dhe shehidëve”* (shënon Tirmidhiu dhe e cilëson të saktë).

Është vërtet e vështirë, që gjatë raportit me njerëzit, tregtari të tregohet i singertë, andaj edhe Muhamedi (lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të) premtoi se fundi i tregtarit të singertë është i lavdëruar, dhe rezultati i tij është ai që do

Prandaj, tregtarët është e domosdoshme të kenë parasysh dispozitat dhe këshillat të cilave duhet t'u përmbahen gjatë marrëdhënive me njerëzit, pastaj të njihen edhe me gjërat e ndaluara, nga të cilat duhet të largohen, duke shpalosur kështu gjatë punës së tyre moralin e lartë Islam.

të shpresonte çdonjëri.

Sinqeriteti, përveç shpërblimit që sjell në botën tjetër, ka dobi të shumta edhe për këtë botë. I Dërguari (lavdërimi dhe pagja qofshin mbi të) premtoi reflektim të begatisë në tregtinë që bëhet me sinqeritet. Ai ka thënë: *“Nëse ata dy (shitësi dhe blerësi) janë të sinqertë dhe ia sqarojnë të gjitha njëri-tjetrit, në tregtinë e tyre do të ketë bereqet, ndërkohë që, nëse gënjejnë dhe fshehin diçka (ndonjë mangësi, apo diçka tjetër), do të largohet bereqeti nga tregtia e tyre”* (shënon Buhariu dhe Muslimi).

3. Përmbajtja e dispozitave Islame:

Përmbajtja e dispozitave të Islamit gjatë tregtisë, duke filluar nga ato më të qartat dhe të rëndësishmet, duhet të jenë objektiva e çdo besimtari të sinqertë. Besimtari duhet, gjithashtu, të largohet nga llojet e shitblerjeve të ndaluara, si shitja e asaj çfarë është vlerësuar si haram (alkooli etj), dhe të përmbushë kushtet e shitblerjes, kështu që tregtia e kryer do të jetë e saktë.

4. Largimi nga haramet:

Gjatë punës, nga dëshira e madhe për të nxjerrë sa më tepër fitime, tregtari mund të haset me haramet të ndryshme, si kamata, mashtrimi (hileja), tradhtia, gënjeshtria, padrejtësia etj. Sakaq, edhe dhënia e tepruar pas pasurisë e bën të jetë mospërfillës ndaj zbatimit të urdhrave të Allahut të Lartësuar dhe t'i anashkalojë ato.

5. Mospërdorimi kamatës

Gjëja më e rrezikshme, ndaj të cilës njerëzit nuk tregojnë kujdes, sidomos tregtarët, është ngatërrimi i kamatës

me vjeljen e fajdesë (interesit) që ofrojnë bankat. Në Islam, puna me kamatë është rreptësisht e ndaluar, dhe ky mëkat konsiderohet nga më të rëndit, për të cilin Allahu i Lartësuar pohon se njeriu që punon me kamatë i ka shpallur luftë Atij. Allahu i Lartësuar thotë: *“O ju që keni besuar, kini frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sinqertë hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë, atëherë dijeni se i keni shpallur luftë Allahut dhe të Dërguarit të Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj askënd nuk dëmtoni e as vetë nuk dëmtoheni”* (Bekare, 278-279)

6. Betimi i shpeshtë:

Gjatë shitblerjes, tregtari duhet t'i largohet betimit në Allah, i shtyrë nga qëllimi i bindjes së blerësit për kualitetin e mirë të mallit apo për ta shitur me çmim më të lartë mallin. Kjo për shkak se betimi pa nevojë është i papranueshëm dhe bërja shprehi e tij sjell dëme të sigurta si nga aspekti, i fesë ashtu edhe nga aspekti i kësaj bote. Nga dëmet më të njohura dhe më të sigurta për të gjithë është se betimi pa nevojë dëmton reputacionin dhe humbet besimin te myshterinjtë, andaj Profeti (lavdërimi dhe pagja qofshin mbi të) thotë: *“Betimi e shter mallin dhe e asgjëson fitimin”* (shënon Ahmedi). Gjithashtu thotë: *“Keni kujdes në betimin e shpeshtë gjatë shitjes, për shkak se ai e shter tregtinë, pastaj e çrrënjos fitimin”* (shënon Muslimi).

Ndërsa, sa i përket pasojave në botën tjetër, Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem) na tregon se nga tre grupet e

njerëzve që Allahu i Lartësuar nuk i shikon ditën e gjykimit është: ***“Njeriu i cili e bënë Allahun si mall të tij, nuk blenë gjë vetëm se me betimin në Të dhe nuk shet gjë vetë se me betimin në Të”*** (shënon Bejhekiu)

7. Ngrënia në peshore:

Fjala është për tregtarin, që gjatë shitjes së mallit t'i largohet ngrënies në peshore gjatë matjes apo pakësimit të sasisë gjatë numërimit. Allahu i Lartësuar e ka ndaluar këtë dhe u tërhoq vërejtjen me kërcënim atyre që veprojnë kështu në ajetet kuranore: ***“Të mjerët ata që peshojnë! Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u matin ose u peshojnë të tjerëve, u lënë mangët.”*** (Mutafifin, 1-3).

8. Largimi i tradhtisë dhe mashtrimit (gënjeshtërs):

Tradhtia dhe mashtrimi janë dukuri mjaft të rrezikshme në shoqëri. Te shumë njerëz, këto vese janë bërë element i dukshëm gjatë marrëdhënieve ndërnjerëzore, madje, disa i rendisin këto edhe si aftësi mjaft të çmuara, që duhen njohur dhe lëvruar mirë, nëse dëshirojmë përparim dhe avancim në punën që e bëjnë. Për shumë tregtarë, këto vese shihen si shkathësi dhe mjeshtëri që luajnë rol të rëndësishëm gjatë tregtisë. Fatkeqësisht, shumë nga ata besojnë se pa tradhti, ose së paku pa gënjeshtëri, është e pamundur të fitohet, mend si mashtrimi dhe gënjeshtëria të jenë bërë pjesë të këtij profesioni! Prandaj, te njerëzit është e përhapur bindja se personi më i pabesueshëm në shoqëri është tregtari. Sakaq, ne e dimë tashmë se Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem) ka qenë tregtar dhe e ka lavdëruar këtë

punë, pastaj, shumë nga shokët e tij si Ebu Bekri, Uthmani etj., kanë qenë tregtarë të njohur. Por, të gjithë këta në punën e tyre kurrë nuk e kanë përdorur mashtrimin dhe gënjeshtërin për të nxjerrë fitime të padrejta.

Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: ***“Në një rast, ndërsa Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem) ishte në treg, kaloi afër një togu (grumbulli) ushqimesh (që ishte për shitje), kur e futi dorën në të, atij iu njomën gishtat (nga lagështira). Ai tha: ‘O pronar i ushqimit, çfarë është kjo?’ Pronari tha: ‘O i Dërguar i Allahut, e ka zënë shiu (ushqimin)’ Ai i thotë: ‘Po t’i kishe vënë (të njomat) mbi ushqim që ta shohin njerëzit.’ Pastaj tha: ‘Nuk është prej nesh ai që na tradhton.’*** (shënon Muslimi dhe Tirmidhiu).

9. Përshkrimi i drejt i mallit që i ofrohet blerësit, apo gjatë reklamimit:

Nga hadithi i fundit i përmendur, kup-tohet mjaft qartë se nga çfarë kriteresh duhet të nisemi, nëse dëshirojmë të bëjmë marketing rreth mallit që e kemi në shitje. Mënjanimi i hipokrizisë dhe gënjeshtërsisë është thelbësor në këtë, çka vërtetohet me pjesën e fundit të hadithit: ***“Nuk është prej nesh ai që na tradhton.”***

Por, kjo nuk nënkupton aspak se, nëse ka ndonjë mall që nuk është cilësor ose ka ndonjë defekt, njeriu mos ta nxjerrë në shitje, apo se është i ndaluar të shitet. Shitësi ka të drejtë t'i shesë të gjitha llojet e mallrave edhe nëse kanë ndonjë defekt, por në këtë rast ai duhet ta ketë parasysh që ta informojë blerësin për të metat e mallit. Po ashtu, gjatë vënies së çmimit, ai duhet ta caktojë duke marrë parasysh edhe defektin e mallit. Në hadithin e lartpërmendur, Muhamedi

(salAllahu alejhi ue selem) e porositi tregtarin që kishte venë drithërat e dëmtuara nga shiu poshtë, që t'i vërë të njomat përmbi, t'i shohin njerëzit dhe kush dëshiron ta blejë, të kuptojë se çfarë lloj ushqimi është duke iu ofruar.

10. Të tregojë bujari dhe mirësjellje me myshterinjtë:

Kjo shpaloset duke bërë lëshime në çmim gjatë pazarit, gjithashtu edhe shtimi i sasisë gjatë matjes, pasi që në këtë ka bereqet dhe mirësi. Shtimi i sasisë gjatë matjes nuk humbet dhe konsiderohet sadaka ndaj blerësit. Gjithashtu, kjo është formë e mbjelljes së mëshirës, dashurisë dhe ndjenjave të mira. Pastaj, kjo forcon edhe kredibilitetin e tregtarit dhe reputacionin e tij, kështu që ky tregtar do të fitojë myshterinjtë të rregullt, që nuk do ta tejkalojnë atë gjatë blerjes së nevojave të tyre. Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem) ka thënë: *“Allahu e mëshiroftë robin që është bujar kur shet, bujar kur blen dhe bujar kur gjykon”* (shënon Buhariu), që do të thotë se është fisnik dhe zemërgjerë, e jo cikërrimtar për çdo gjë.

Kurse për mirësjelljen transmetohet se Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem) pa një grup njerëzish duke tregtuar dhe u tha: *“O tregtarë!”* Ata iu përgjigjën thirrjes së Muhamedit (salAllahu alejhi ve selem) duke i ngritur kokat dhe sytë nga ai. Ai u tha: *“Vërtet tregtarët do të ringjallen ditën e gjykimit mëkatarë, përveç atyre që patën frikë (Allahun) ishin bamirës (të mirësjellshëm) dhe të sinqertë”* (shënon Tirmidhiu dhe e cilëson të saktë)

11. E drejta e zgjedhjes (hijarit):

Transmetohet nga Hakim b. Hizami

(Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Të dy, shitësi dhe blerësi, kanë të drejtën e zgjedhjes përpara se të ndahen (gjatë tregtimit). Nëse ata dy janë të sinqertë dhe i sqarojnë të gjitha njërit-tjetrit, në tregtinë e tyre do të ketë bereqet, nëse gënjejnë dhe fshehin diçka (ndonjë mangësi, apo diçka tjetër), do të largohet bereqeti nga tregtia e tyre”* (shënon Buhariu dhe Muslimi).

Edhe shitësi edhe blerësi kanë të drejtën e zgjedhjes dhe mendje-kthimit (për tregtinë që kanë bërë) derisa janë ende në të njëjtin tubim. Kjo është kështu për shkak se gjatë shitblerjes ndërmjet palëve, nganjëherë ndodh që të bëhet tregtia pa menduar mirë dhe me nxitim, prandaj është e mundur që ndonjëri nga ata dy të pendohet për atë tregti. Profeti (lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të!) i dha afat secilit si shans të mendojë mirë për tregtinë që bën dhe të zgjedhë derisa mos të ndahen (shitësi dhe blerësi). E kur të ndahen, atëherë asnjëri nuk ka të drejtë ta prishë atë tregti, përveç rastit kur ndonjëri nga këta dy kushtëzon që t'i japë të drejtën të mendojë një kohë dhe, nëse brenda asaj kohe pendohet, të kthehet.

12. Dhënia e sadakasë:

Çdo njeri, gjatë marrëdhënieve me të tjerët apo gjatë punës që kryen, gabon dhe mund të mëkatojë, madje, shumë herë edhe pa e kuptuar. Kurse te tregtarët shansi për mëkat është shumë më i madh dhe më i mundshëm. Sadakaja (lëmosha) ndaj të varfërve dhe nevojtarëve është mënyra më mirë për ta pas-truar veten nga këto mëkate, e për të pastruar gjithashtu edhe pasurinë e fituar. Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem)

thotë: “O tregtarë! Shitblerjes suaj i shfaqen dhe i shoqërohen shumë kotësi (fjalë të kota të panevojshme) dhe gënjeshtër, prandaj gërshetoheni atë (tregtinë) edhe me dhënien e sadakasë” (shënon Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu)

13. Largimi nga monopoli:

Monopoli (ose ihtikari) është në ato raste kur tregtari tërheq nga tregu mallin ushqimor që është i nevojshëm dhe i kërkuar për njerëzit (ka mungesë në kohën e krizës), ose e blen të tërin nga tregu që ta fshehë, me qëllim të ngritjes së vlerës së çmimit dhe më pastaj ta nxjerrë ne treg dhe ta shesë më shtrenjtë. Me fjalë tjera, monopolizimi i artikujve ushqimorë në kohën e skamjes dhe mbizotërimi i rritjes së çmimit nga ana e tregtarëve, atëherë kur njerëzit ndiejnë krizë për gjërat elementare të jetesës, është i ndaluar. Dispozitat rreth kësaj janë të sqaruara gjerësisht në librat përkatëse dhe nuk do të zgjerohemi më shumë në këtë, do të përmendim vetëm hadithin në të cilin Muhamedi (salAllahu alejhi ve selem) thotë: “Vetëm mëkatari monopolizon mallin”(shënon Muslimi).

14. Dhënia e tepruar pas pasurisë:

Njeriu që jepet pas fitimeve dhe derdh mundin në këtë duhet ta kuptojë se rizku (furnizimi) vjen vetëm nga Allahu i Lartësuar. Prandaj të ketë kujdes në këtë dhe të mbështetet tek Ai që ka në dorë furnizimin, e Ai është Allahu i Lartësuar dhe të mos jepet vetëm pas sebepeve që e dërgojnë nga fitimet, duke harruar Krijuesin e këtyre sebepeve.

Fatkeqësisht, nëpër tregje është përhapur padituria dhe njerëzit nxitojnë vetëm pas gjësëndeve dhe pasurisë. Shumë nga njerëzit mendojnë se i tërë

fitimi është i lidhur vetëm pas aftësive, njohurive, mendjemprehtësisë dhe gjuhës së rrjedhshme të tregtarit; tek ata çdo gjë mbështetet në llogari dhe statistika, që i bëjnë vazhdimisht. Kështu që i kanë lënë anash mbështetjen tek Allahu i Lartësuar dhe përmbajtjen e normave Islame.

Muhamedi (lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të) thotë: “O njerëz kini frikë Allahun dhe bëhuni të mirë në kërkimin e pasurisë, vërtet nuk ka njeri që do të vdesë pa e marrë hisen e tij të rizkut, kështu që, nëse i ngadalësohet atij (rizku), atëherë le të ketë frikë dhe le ta kërkojë atë mirë (me rrugë të lejuara, pa teprim), merreni atë që keni hallall dhe lini atë që është haram” (shënon Ibën Maxhe dhe Hakimi e cilëson të saktë)

15. Largimi nga gjërat e dyshimta:

Këtu është fjala për largimin nga punët apo tregtia që nuk është e sigurt se janë të pastra nga haramet dhe ndalesat. Këtu hyjnë edhe punët që njeriu i kryen fshehurazi dhe nuk do që të tjerët ta shohin. Profeti (lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të) thotë: “Hallalli dhe harami janë të qartë. Ndërmjet tyre gjenden gjëra të dyshimta, të cilat nuk dihen nga shumica e njerëzve. Kush largohet nga gjërat e dyshimta, e ka ruajtur nderin dhe fenë e tij. Ndërsa, kush kryen gjëra të dyshimta, është futur në zonën e haramit...” (shënon Buhariu dhe Muslimi)

Referencat:

- “Fikhul Muamelat el-Maliye el-Muasire el Mukarin”, dr. Alaudin Za`teri.
- “El-Muamelat el-Maliye el-Muasire”, prof. dr. Vehbe Zuhejli
- “Et-Taxhiru Mu`min”, Abdulkarim El-Omeri

Shqiptari, emigrimi dhe identiteti i tij

Shkruan: Mirsim MALIQI

Çfarë na ofrohet?

Duke shfletuar faqet e historisë sonë kombëtare, do të vëresh pa dyshim se populli ynë është përpjekur gjithnjë që të ruajë të pacenuar identitetin kombëtar dhe të mbrojë integritetin e trojeve të veta, ato të Shqipërisë Etnike. Sakaq, shfletim i historisë kombëtare nuk do përkon aspak me ndjekjen e një filmi 'historik' me brumim të natyrës komuniste-sovjetike rreth Shqipërisë së para gjashtë shekujve, në të cilën Gjergj Kastrioti¹ Skënderbeu² pas luftës në Krujë, kur hyn në skenë si prijës i popullit të tij³, të pranishmëve u thotë: "o shqiptarë", në një kohë kur fjala 'shqiptar' s'ekzistonte fare⁴, gjë që tregon realitetin e paqëndrueshëm historio-ografik të shkruarit të asaj shëmbëlltyre të historisë.

Për të mësuar historinë e popullit tonë, sot lexuesi shfrytëzon literaturë

të huaj, gjegjësisht serbe apo greke, çka është vërtet brengosëse. Nevoja për flakjen e teksteve filo-serbe nga bankat e shqiptarëve, s'ka dyshim që është diçka e domosdoshme dhe e pashmangshme. Sot, në kohën e lirisë së fjalës, pas shkëputjes nga sistemi sllavo-komunist - sistem i instaluar nga serbet⁵ në Shqipërinë tonë - shqiptarët s'kanë kurrfarë arsye të mendojë akoma si Enveri, shërbëtori besnik i marksizëm-leninizmit, i cili u nguliti shqiptarëve përmes dhunës dhe mekanizmit të shpëlarjes së trurit idenë se këta shpëtuuan e dolën fitimtarë në kohën kur u shkëputën nga Perandoria Osmane, e cila punoi për disa shekuj duke u mbështetur në parimet e Sheriat (Sistemin e Zotit). Enveri mendonte kështu dhe impononte të njëjtin mendim, sepse ish i ngarkuar me këtë mision nga serbet, të cilët vetëm atëherë (1912), kur shqiptarët u ndanë

¹ Mbiemri i Gjergjit në greqishtë do të thotë: kështjellë, kala.

² "Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës malazeze Vojsava, fëmija i fundit midis 4 djemve dhe 5 vajzave" (<http://sq.wikipedia.org/wiki/Skenderbeu>) (Shënim: Në referencën e cituar identiteti malazez i Vojsavës tani mungon, me që është hequr prej sajtit, nga ku më parë jemi referuar). Mendohet se lindi më 6 maj 1405. Njihet ndryshe si Skënderbeg (Aleksandër).

³ Mos harrojmë se ky "popull" nuk ishte vetëm ajo pjesë e popullsisë që jetonte në Krujë apo në rrethinat e saj.

⁴ Shqiptarët aso kohësh quheshin "arbër".

⁵ Këtë na e treguan vetë komunistët, gjegjësisht Mehmet Shehu kur (22. 09. 1944) i shkroi letër Dushan Mugoshës, ku ndër të tjera i thotë: "Nuk kishim Parti, (...), e me udhëzimet e Mlladinit dhe të tuat, me ndihmat tua mundëm të seleksionohemi, të formojmë Partinë Komuniste, ta forcojmë." (Shih: Prof. Dr. Novica Veljanovski e të tjerë, Historia për vitin III të arsimit gjimnazor, PROSVNETNO DELLO SHA (Shkup, 2006), f. 134).



nga Perandoria Osmane, pushtuan tokat e shqiptarëve, çka nuk patën mundësi që ta bënin më herët, në kohën kur aleati i shqiptarëve ishte Perandoria Osmane, pjesë përbërëse e të cilit qe edhe Shqipëria. Madje, nuk mbeti me kaq, ai (përhapësi i ideve komuniste) vazhdoi me të njëjtën egërsi kundër shqiptarëve, e sidomos ndaj atyre myslimanë, njëloj siç kishin vepruar punëdhënësit e tij 6 dekada më parë. Prandaj, lipset thënë që në fillim se antishqiptarizmi i krijuar

Kryqtarët ortodoksë serbë, të cilët nxitën masakrimin e mijërave shqiptarëve, si në fillim të shekullit të njëzet, po ashtu edhe në fund të tij, - dhe, pavarësisht se fundamentalistë fetarë kishtarë, akoma zënë vend të rëndësishëm në Serbi, - mbeten sinonim i së keqes dhe krimit në Evropë,

nga një kryetradhtar s'mund të merret parasysh, dhe e njëjta gjë vlen edhe përsa i përket historiografisë në lidhje me historinë e popullit tonë, krenaria e të cilit u ngrit në kohën kur ishte mik e akra-ba me perandorinë më të fortë të kohës.

Rreth shtypjes...

Gjatë gjithë kohës, - po flasim për dy shekujt e shkuar, - ndaj shqiptarëve u ushtrua një dhunë sistematike. Dihej se, ajo çka i pengonte shtypësit ishte identiteti i shqiptarëve. U bënë kongrese

⁶ Gazeta Express (24 Janar 2008), botoi raportazhin e 31 dhjetorit të vitit 1912 të gazetës "The New York Times", "Vrasjet si sport ditor" në të cilën tregohen masakrat e tmershme ndaj shqiptarëve, në të cilën përmenden emrat e qyteteve me banorë shqiptarë myslimanë, ndër to, Shkupi, Kumanova, Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova e disa vende të tjera, në të cilat serbet kishin filluar masakrat me synimin, siç transmeton i dërguari i "Daily Telegraph" se: "deklaruan se qetësimi më i efektshëm i Shqipërisë është zhdukja totale e shqiptarëve muhamedanë".

padrejtësish, mashtrimesh dhe çrregullimesh, ndër to Kongresi i Berlinit (1878)⁷, më vonë Konferenca e Londrës, e të tjerë, porse asnjëra s'ishte në favor të së vërtetës rreth popullit shqiptar.

Ortodoksët serbë, pas largimit të osmanëve, filluan gjenocidin kundër shqiptarëve, e sidomos ndaj shqiptarëve të Kosovës, me pretekstin se gjoja: "Kosova paska qenë në mesjetë qendër e shtetit serb dhe trevë e banuar nga serbët deri në fund të shek. XVII - fillimi i shek. XVIII, kur pas luftës austro-osmane të viteve 1683-1699 një pjesë e popullsisë serbe që mori anën e Austrisë, qenka tërhequr për në veri dhe vendin e saj e paskëshin zënë shqiptarët e ardhur nga viset e brendshme malore të Shqipërisë së Veriut"⁸, çka janë thjesht propagandë, pa kurrfarë themeli historiografik. Kryqtarët ortodoksë serbë, të cilët nxitën masakrimin e mijërave shqiptarëve, si në fillim të shekullit të njëzet, po ashtu edhe në fund të tij, - dhe, pavarësisht se fundamentalistë fetarë kishtarë, akoma zënë vend të rëndësishëm në Serbi, - mbeten sinonim i së keqes dhe krimit⁹ në Evropë, siç mbeten

të tillë pararendësit e tyre kishtarë famëkeq me kryqëzatat e tyre në tokat e myslimanëve, gjegjësisht aty ku dolën dijetarët dhe shkencëtarët më të ditur e njohur, në Kordobën e famshme, që "ishte qyteti më i pasur në Botë".¹⁰

Shtypja e shqiptarëve ende vazhdon, më vonë, "Pas rënies së Janinës, ushtria greke hyri në Çamëri. Pushtimi u shoqërua me mizoritë e shumta të bandave greke kundër popullsisë civile shqiptare. Çështja çame dhe përgjithësisht çështja e minoritetit shqiptar në Greqi, lindi me vendimin e Konferencës së Londrës më 1913, Çamëria ra nën sundimin grek."¹¹

Mbi popullatën çame (60.000 myslimanë e 20.000 të krishterë) ushtrohej një dhunë e madhe. Mit'hat Frashëri, shkruante pandërprerë se ç'po ndodhte me myslimanët e Çamërisë. Ai, kur i shkruan (23 qershor 1923) Ministrit të Punëve të Jashtme në Tiranë, ndër tjera i thotë: "Këtu të bashkuar ke edhe kopjen e një note verbale që dhashë sot për vështirësitë që po hasin shqiptarët myslimanë në udhëtimet e tyre, në kufijtë grekë"¹² dhe në shumë letra të dërguara

⁷ Pas së cilit u shfaq Lidhja Shqiptare e Prizrenit, rreth së cilës Prof. Dr. Muhamet Pirraku thotë: "Rreziku i drejtpërdrejtë i copëtimit të Shqipërisë ishte evident. Ndaj, kjo vuri në lëvizje të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare. Grupi parlamentar shqiptar tuboi rreth vetes personalitetet intelektuale dhe ushtarake me autoritet në nivelet regionale, kombëtare dhe ndërkombëtare me detyrë të qartë: T'i dilet zot Shqipërisë. Midis aktivistëve në këtë drejtim shquhej Sheh Ymer Prizreni, i cili, me urgjencën që shtronte momenti historik, themeloi të parën organizatë politiko-ushtarake "Ittifikak" (Lidhja) me seli në Prizren, e cila për një kohë të shkurtër u rrit në "Besëlidhje" nën drejtimin e parlamentarit Ymer Prizreni, me detyrë të mbarështronte organizimin e mbrojtjes vullnetare të Vilajetit të Kosovës nga sulmet eventuale të Serbisë dhe të Malit të Zi." (Shkëputur nga: Teksti shqip i rezimësë anglisht të veprës: Myderriz Ymer Prizreni - Ora, Zemra dhe Shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887 të Muhamet Pirrakut, Prishtinë, 2005, fq. 522). Me që, gjithnjë kur përmendet Lidhja Shqiptare e Prizrenit shoqërohet edhe emri i Myderriz Ymer Efendi Prizrenit, po citoj edhe ato që thotë Prof. Dr. Xheladin Shala, në shkrimin e tij: "Ymer Prizreni figurë e rëndësishme e rilindjes kombëtare" rreth tij: "Myderriz Ymer Efendi Prizreni bën pjesë në lagjen e figurave më të rëndësishme të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Rëndësia e tij është aq më e madhe kur kemi parasysh se emri dhe përpjekja e tij janë të lidhura me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ngjarje kjo më e rëndësishmeja në historinë kombëtare shqiptare. Megjithatë, historiografia jonë gjatë kohës ka qenë mospërfillëse ndaj rolit të Ymer Prizrenit".

⁸ Shih: Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, (Tiranë, 1990), f. 73
⁹ "Në luftën e Kosovës, që filloi prej 28 shkurt 1998 e që vazhdoi deri më 23 mars 1999, u dëbuan 800.000 mijë shqiptarë, u vrane 15,000 persona, nga të cilët 2,400 luftëtar të UÇK-së e të tjerët civilë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara" (Shih: http://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Kosov%C3%ABs)

¹⁰ Shih: Abdusamed Nasuf Bushatliq, *Endelusi Përkujtim dhe vërejtje*, përkth. Behxhet Jashari, Klubi Studentor (Shkup, 2007), f. 157

¹¹ Shih: Beqir Meta, *Tragjedia çame*, Instituti i studimeve për Çamërinë (Tiranë, 2007), f. 28

¹² Shih: Dr. Kaliopi Naska, *Dokumentet për Çamërinë*, Drejtoria e përgjithshme e arkivave (Tiranë, 1999), f. 95

kërkon ndihmën dhe ndërhyrjen e shtetit shqiptar për t'i ndihmuar çamët, gjegjësisht ata myslimanë, ndaj të cilëve ushtrohej me presion këmbimi me grekë, përkatësisht dërgimin e çamëve myslimanë në Turqi dhe sjelljen e grekëve në tokat çame. Kur panë vendosmërinë e çamëve për të qëndruar në tokat e tyre, atëherë filluan të ushtrojnë edhe dhunë, derisa shumë prej tyre i larguan nga trojet e tyre, në të cilat lanë familjarët e tyre të masakruar, në tokën e Çamërisë, në të cilën bëhej spastrim etnik.¹³

E gjithë kjo dhunë ndodhi ndaj shqiptarëve, vetëm atëherë kur më shqiptarët s'ishin afër osmanëve, akrabatë më besnikë, të cilët kurrë nuk ushtruan dhunë ndaj tyre. Siç tregon edhe Joseph Rothchild për shqiptarët se: "Ata ishin të fundit që vendosen të shkëputeshin nga Perandoria Osmane, struktura e elitës të së cilës kishte qenë gjithmonë e hapët ndaj bijve të tyre të talentuar dhe ambiciozë, e cila përgjithësisht nuk i kishte shtypur ata dhe ndaj Kalifit-Sulltan të së cilës shumica e tyre ndiente një nderim të mirë-filltë fetar"¹⁴.

Shqiptari...

Ecëm sa ecëm, derisa arritëm tek tema jonë... Shqiptari! Kush është Shqiptari? Për kë jemi duke folur?

Ai është muhadiithi i shquar Muhamed Nasirudin, i biri i Nuh Nexhatit, të birit të Ademit. U mbiquajt elAlbani (Shqiptari), sipas vendlindjes së tij, Shqipërisë. Ai lindi në vitin 1332h/1914g, në qytetin e Shkodrës, një nga qytetet kryesore të Shqipërisë¹⁵. Ndoshta shqiptarët s'dinë shumë për të, pavarësisht se ka njerëz që thonë për të, si Shejh Bin Bazi: "S'di të ketë nën qiell dijetar më të madh në hadith për këtë kohë sesa Shejh Nasiri (Albani)".

Emigrimi...

Kur Shqiptari (Më tej: Shejh Albani) ishte vetëm nëntë vjeç, familja e tij u shpërngul nga Shqipëria, e cila i kish hapur dyert shekullarizimit, çka i parapriu komunizmit famëkeq, për të cilin folëm më parë. I ati i Shejh Albanit e pa të arsyeshme (për të ruajtur identitetin fetar) të shkojë me familjen e tij në Sham, vendi i diturisë dhe i tregtisë, për të cilën populli ynë thoshte: "Deri në Sham me dasht me hy, s'kemi ymër me ja mrriri".¹⁶

Identiteti i tij...

Nëse lexojmë literaturën islame në çdo cilën gjuhë të botës qoftë, të shkruar nga dijetarët e kohës sonë, do të vërejmë se, përse i përket autenticitetit, vlerësimit apo verifikimit të transmetimit të haditheve, ata i refero-

¹³ "Por përpara masakrës së korrikut, forcat e EDES-it kishin kryer një valë tjetër masakrash në qershor. Gjithashtu, pas verës pasoi një fushatë tjetër në tetor të vitit 1944 e cila bëri të plotë spastrimin etnik të Çamërisë. Rezultatet e këtij spastrimi kanë qenë me të vërtetë tragjike. Nga një popullsi prej 35000 vetësh që ishte para luftës mbetën vetëm disa dhjetëra familje. Vetëm në tragjedinë e Filatit dhe të Paramithisë që u zhvillua në qershor dhe tetor të vitit 1944, rezultati ishte: 2000 të vrarë, gra, fëmijë, pleq dhe burra të paarmatosur, të masakruar në mënyrën më çnjerëzore nga bandat zerviste." (Shih: <http://sq.wikipedia.org/wiki/%C3%87am%C3%ABria>)

¹⁴ Joseph Rothchild, *Europa Lindore Qendore midis dy luftërave botërore*, përkth. Kujtim Ymeri dhe Sabina Ymeri, Shtëpia Botuese Dituria (Tiranë, 2004), f. 351

¹⁵ Shih: Ibrahim Muhamed El Alj, *Jeta dhe vepra e Shejh Muhamed Nasirudin Albanit: Muhadiithi i kohës dhe ringjallësi i Sunetit*, përkth. Alban Kodra, Nektari (Tiranë, 2004), f. 19

¹⁶ Shih: Muhamed Mufaku, *Prapa Natës – Poezi e shqiptarëve të Sirisë*, Rilindja (Prishtinë, 1980), f. 3

hen Shejh Albanit, aq sa për punën e tij, dijetari i shquar, Shejh Muhamed elUthejmin, tha: “Përsa i përket analizave dhe verifikimeve shkencore, s’ka si ai”.¹⁷

Shejh Albani thoshte: Unë jam shqiptar. Madje, këtë fjalë ia thoshte edhe gjithë botës në arabisht **“Ene alban-ijj”**. Ai jetoi në tokat arabe afër tetëdhjetë vjet, por kurrë s’e harroi gjuhën shqipe, ruajti identitetin e tij kombëtar dhe u kujdes për studentët shqiptarë, sa që në ligjëratat e tij (të incizuara në gjuhën shqipe), shpesh ai i pyet studentët e tij për çështjen shqiptare në Kosovë dhe u jepte gjithashtu këshilla. Po pse populli ynë s’e njeh? Vallë, s’kemi kohë të merremi me shqiptarët, bijtë e shqiptarëve, të cilët për 7-8 dekada ishin larg vendlindjes së tyre, por që kurrë s’e harruan vendin e tyre, madje, emrin e atdheut e vendosën në mbiemrin e tyre?! Apo, më përparësi ka ajo që thoshte: **“Ami Bharater Bharat Amar”**— Unë jam indiane, India është e imja¹⁸? Apo, vallë, i kemi dhënë përparësi atij që futi popullin e vet në luftë për interesat e Krishterimit, ndërsa sot e quajmë hero kombëtar, në të njëjtën kohë kur Vatikani e quan “Kalorësi i Krishterimit” apo edhe “Mbrotjtës i Krishterimit”¹⁹?! Pse s’e njohim Shejh Albanin?

Rreth shtypjes...

Tani do të kthehemi prej udhëtimit tonë, aty ku u nisëm... Te shtypja ndaj shqiptarëve!

Kohët e fundit jemi dëshmitarë të misionarizmave antishqiptare-antimyslimane, të cilët duan të deformojnë përkatësinë e shqiptarëve. Islamofobia është e dukshme... Në çdo pikë mundohen të largojnë Islamin, fenë e shumicës së shqiptarëve. Kjo shtypje ndaj kulturës islame të shqiptarëve s’do mend që është çnjerëzore. Figurat më të shquara të shqiptarëve myslimanë s’i përmend asnjë historian, pavarësisht se pa to është krejt e pamundur të përftohet në ploti fytyra e kombit dhe kultura e shqiptarëve.

Në shkrimin e tij “Identiteti Islam i shqiptarëve, Mit apo Realitet?”, Ermal Bega shprehet bukur: “Nuk arrij të kuptoj se përse po bëhet kjo politikë kaq e poshtër anti-islame në Shqipëri. Islami është një besim i cili kurrë nuk ka krijuar probleme tek ata të cilët e praktikojnë, dhe askush tjetër nuk ka parë ndonjë gjë të keqe nga ai besim dhe nga këta besimtarë.” E që, pyetjes së tij po i përgjigjemi me fjalët e Dr. Hysen Çobanit: “Ata duan të na bëjnë të krishterë, se ashtu i hiqen halat peshkut dhe gëlltitet më lehtë. Por, kjo nuk do të ndodhë kurrë”.

¹⁷ El Alij, *op.cit.*, f. 8

¹⁸ Shih: Gëzim Alpi, *Media, ethnicity and patriotism - the Balkans 'unholy war' for the appropriation of Mother Teresa*, f. 12

¹⁹ Kur vdiq “Kalorësi i Krishterimit”- Gjergj Kastrioti, Sulltan Murati nuk tha “Mjerë Shqiptaria”, por tha: “Mjerë Krishterimi, se i humbi shpata dhe mburoja!” (Shih: Dr. Remzi Nesimi, *Gjuhë shqipe dhe letërsi*, Prosvetno Dello Sha, f. 73) “Në Gjysmën e dytë të shekullit të XIV në hartën gjeopolitike të Evropës Kristiane të atëhershme shfaqet një fuqi e madhe-Turqit- Osman” prandaj “Në republikën e Venedikut si dhe në Gjenovë bien këmbanat e rrezikut për Evropën:Vatikani përgatitet për kryqëzata, jo për Jeruzalemin, por për shpëtimin e Carigradit i cili gjendet i rrethuar” e që Skënderbeu iu përgjigj kësaj thirrjeje, me që kishte mbështetjen e popujve ballkanik porse “Bashkëlufitëtarët e tij ishin edhe maqedonasit”. (Shih: Akademik Ali Aliu e të tjerë, *Skënderbeu 1405-1468*)

Binjaket

47

Dominik Zhaklin Kanzig dhe Daniela Storm Kanzig janë binjake 18-vjeçare. Të dyja besojnë fuqishëm në Zot; njëra prej tyre është myslimane. Ato ende ngajnë si dy pika uji.

Dominik Zhaklin Kanzig:

Daniela dhe unë kemi qenë vazhdimisht fëmijë të çapkëne, shpesh kemi krijuar edhe probleme, derisa u rritëm. Prindërit tanë janë ndarë kur ne ishim dy vjeç; disa vite kemi qenë vetëm me nënën. Megjithatë, gjithë kujtimet e mia janë të mira, madje, edhe kur kemi pasur probleme të mëdha. Kur bëhej fjalë për karakterin, unë isha si djalë, kurse

Daniela ishte vajzë e vërtetë. Sot është krejtësisht e kundërta! Gjithmonë kemi qenë të lidhura me njëra-tjetrën dhe asnjëherë nuk jemi ndarë, derisa hymë në shkollën fillore. Atëherë na ndanë dhe na vendosën në klasa të ndryshme, ngase mësuesit e panë të arsyeshme, pasi mjaft shiheshim së bashku në shtëpi. Kjo ishte e rëndë për ne; çdo pushim mes orëve gjenim njëra-tjetrën e qëndronim bashkë aq sa mundeshim. Siç rriteshim ne, rritej edhe shoqëria jonë në shtëpi dhe jashtë saj. Secila nga ne zhvillonte rrethin e saj të shokëve.

Çapkënlleqet tona fëmijërore ndonjëherë ishin të rrezikshme, sidomos një



Gruaja dhe familja

rast, kur vendosëm të luanim në kopshtin tonë. Aq keq u rrëzuam, saqë të dyja u alivanosëm. E para që fitoi vetëdijen e humbur isha unë; kisha një plagë në ballë, nga e cila dilte gjak. Daniela kishte plagë edhe më të thellë, nga e cila rridhte shumë gjak. Hymë në shtëpi të kërkonim mamane dhe më kujtohet Daniela, e cila merrte një nga një jastëkët prej kauçit dhe fshinte gjakun nga fytyra. Asnjëherë nuk e kam pasur të qartë pse e bëri një gjë të tillë. Urgjentisht u dërguam në spital, e ja tek mbijetuam për ta rrëfyer këtë ndodhi.

Gjatë rritjes, kam biseduar shpesh me Zotim tim, dhe e kam lutur. Kur nisa të lexoj për herë të parë mbi Islamin, lutjet e mia ishin shumë të fuqishme. Falë Allahut, u bëra myslimane në fillim të Ramazanit të vitit 2002. Gjurmimi im pas diturisë ka filluar pas bisedave për çështje fetare me një shok të shkollës, i cili është mysliman. Çdo send që thoshte kish kuptim. Vazhdonte të bisedonte me mua çdo ditë, aq sa pata mundësinë të parashtroja çdo pyetje që më grishte. Kalova një vit duke mësuar Islamin, duke biseduar me myslimanët, para se të vendosja të bëhesha myslimane. Familja ime çuditej. Një here u ktheva në shtëpi dhe mamaja më pyeti përse mendoja që Islami është feja e vërtetë, mirëpo nuk isha e sigurt. Para se të filloja të flisja, ajo më tha: "Ndiq zemrën tënde". Dhe kjo është ajo që kam bërë. Tre motrat e mia, nëna dhe të tjerët më kanë përkrahur shumë, më kanë ndihur të kuptoj vlerën e dashurisë së painteresët.

Asnjëherë nuk kam qenë më e gëzuar sesa tani.

Sa herë bisedoj për Islamin, ndjej se jam afër Allahut, dhe kjo është ndjenjë e pa përshkruar. Kur nisa të fal namazin, isha aq mirë, sa ndjeva brenda vetes qetësi dhe kënaqësi, të cilën asnjë lutje nuk ma pati dhënë më parë.

Babait tim iu desh një kohë e gjatë ta pranojë fenë time. Gruaja e tij është braziliane dhe është lindur në familje myslimane, mirëpo nuk e ka praktikuar fenë. Është keqardhje që përvojat e saj janë kthyer kundër Islamit, por kjo është dëshmi se të gjithë duhet të fokusohemi në Islam, a jo ndaj asaj se si sillen myslimanët.

Kam pasur fat, që shumë njerëz më kanë ndihmuar të gjej Islamin dhe të mësoj për të. Në fillim gjithçka ishte në formë emocionesh dhe dëshiroja që brenda një nate të bëhem myslimane e përsosur, kështu që vendosa që të ndryshoj përnjëherë. Kur kjo filloi të rëndohet, isha e shqetësuar, mirëpo shpejti u qetësova e nisa t'i bëj gjërat në mënyrë të logjishme.

Asnjëherë nuk kam qenë më e gëzuar sesa tani. Sa herë bisedoj për Islamin, ndjej se jam afër Allahut, dhe kjo është ndjenjë e pa përshkruar. Kur nisa të fal namazin, isha aq mirë, sa ndjeva brenda vetes qetësi dhe kënaqësi, të cilën asnjë lutje nuk ma pati dhënë më parë.

Daniela dhe unë kemi kaluar shumë kohë duke biseduar për fe. Sa herë që kisha mundësi, debatoja me të rreth Islamit, se vërtet dëshiroja që edhe ajo të gjente atë që kisha unë. Ajo ishte burim i madh për mua dhe përkrahja e saj asnjëherë nuk është dobësuar. Kur vendosa të mbaj hixhabin, ajo më inkurajonte edhe kur dilnim jashtë, sillej si mbrojtëse ndaj meje.

Veshja e hixhabit ishte luftë e vërtetë. E dija se duhej bërë, dhe kjo më bënte të

nevrikosur. Një natë, i jam lutur Zotit, të ma lehtësonte këtë. Të nesërmen u ngrita e qetësuar, dhe thjeshtë vendosa ta bëj. Ndjekësia shumë e lumtur brenda vetes dhe më kujtohet që kam ecur rrugës me një buzëqeshje shpirtërore në fytyrë, që vinte nga zemra. Kur u bëra myslimane, Daniela dhe unë u bëmë edhe më të afërta, edhe pse nuk kishim bërë disa gjëra për të cilat kishim shprehur. Mendoj se tërë kjo ka kuptim për të, ngase ajo e sheh të arsyeshme se ka shumë gjëra që duhen shmangur, nëse bëhet myslimane dhe se ende nuk është e përgatitur për të.

Unë ende mendoj se çfarë do të bëj në të ardhmen. Shpresoj që të punoj në fushën e mjekësisë dhe se dua që të kujdesem për fëmijët e vegjël. Më shumë se gjithçka, dëshiroj të kem një bashkëshortësi të suksesshme, me një mysliman që praktikon fenë dhe do më kuptojë. Mendoj se Islami është çelës i jetës së lumtur. Po ashtu, lutem që motra ime të ndjekë rrugën time dhe besoj se ashtu edhe do të ndodhë. Sa herë kemi pasur probleme, dhe kur kemi biseduar për këtë, më ka thënë : “Allahu do na ndihmojë”. Unë mendoj se Ai është veç në zemrën e saj.

Daniela Storm Kaenzig:

Të kesh motër binjake do të thotë të kesh shok më të mirë në rrethinë. Dominika dhe unë vazhdimisht vareshim nga njëra-tjetra, derisa u rritëm. Kjo vazhdon edhe tani. Vërtet ishim fëmijë trazovaçë, dhe mamaja brengosej kur bënim prapësina, siç është nxjerrja e gjithçkaje nga dollapi, shkundja e tavllave në dysheme etj. Njëherë ish aq e tmerrshme, sa mamaja vetëm sa na vështroi dhe u largua duke qarë. Këtë e

ka fotografuar, ngase nuk mundi ta besonte se kishim bërë një gjë të tillë. E tërë kjo, padyshim ish e rëndë për të, megjithatë asnjëherë nuk është larguar nga ne.

Nuk jam çuditur që Dominika u bë myslimane, ngase e kam ditur se ka hulumtuar për të vërtetën dhe kam pritur se kjo do të ndodhte. Ndërsa rriteshim, Dominika vazhdimisht thoshte se diçka i mungonte. Mendoj se e kuptoj se çfarë ndjente. Islami e ka mbushur plotësisht atë zbrazëti në jetën e saj.

Ndërsa hulumtonte Islamin, Dominika emocionohet shumë, sidomos kur iu bë e qartë se krejt kjo kishte kuptim. E kisha siguruar se do të kishte përkrahjen time, pa marrë parasysh se ç'ndodh, dhe këtë e pata bërë. Për mua, nuk është me rëndësi se në cilën fe është ajo, ngase ajo ende është motra ime binjake, dhe asgjë nuk mund ta ndryshojë këtë. Nuk mund t'i gjykoj veprat në anën negative, pasi motra ime ka qenë gjithnjë pozitive. Unë jam shtatë minuta më e madhe se ajo, dhe gjithmonë kam ndjerë disi se jam motra më e madhe. Mirëpo, që nga koha kur Dominika u bë myslimane, është bërë më serioze dhe më e ndërgjegjshme, kështu që rolet kanë ndryshuar disi.

Karakteret tona janë mjaft të ndryshme. Thonë se unë kam më tepër vetëbesim, dhe ndoshta është e vërtetë. Dua të jem kureshtarë dhe shkoj përpara. Vërtet shpresoj se së shpejti do të kyçem në policinë ushtarake për disa vite, dhe pastaj të bëhem police e thjeshtë, dhe dua të punoj në njësinë për kriminalitet.

Në fillim isha e interesuar të bëhem avokate, mirëpo punova në odën e

avokatëve, ndërrova mendim. Puna ishte me shumë dokumentacione, ndërsa unë dëshiroj të ketë më tepër aktivitet. Jam përfshirë në kursin për marinsë, që më ka dhënë idenë për t'u trajnuar edhe më shumë dhe t'i futur ushtrisë. Ishte tepër rëndë!

Ishim të detyruara të flinim në tokë, në thasë, pa çadër, dhe kudo kish insekte dhe minj. Ishim të detyruar të flinim me gishtërinj në gojë dhe me kokën të mbuluar, që të ruhesha mos më ecnin në fytyrë.

Ambiciet e mia dallojnë nga ato të motrës sime, por kjo nuk ndikon në lidhjen tonë. Kam menduar rreth Islamit, mirëpo nuk u jam përkushtuar vërtet mësimëve të tij. Çdo mbrëmje e lus Zotin duke besuar në Atë, si dhe lutjet e mia janë shumë të ngjashme me të motrës. Kam filluar të përdor njërën nga sixhadetë e motrës dhe i jam lutur Zotit në të njëjtën mënyrë që bën ajo. Kam pasur shok të afërt mysliman, edhe pse ai nuk praktikonte fenë, dhe kemi biseduar për atë sesi të mësojmë më tepër rreth Islamit, por nuk e interesonte kjo gjë, edhe aq.

I çmoj shumë myslimanët, edhe motrën time dhe jam shumë krenare me të, për shkak të guximit të saj, veçanërisht që kur vendosi të mbajë hixhabin, Çdoherë i nderonte të gjithë shokët e saj. Ka të këqij që mendojnë se ajo është e çmendur, por të tillët duhet injoruar dhe nuk duhet lejuar të afrohen afër nesh. Mendoj se pengesa më e madhe e të kaluarit në Islam është se të gjitha rregullat duhen ndryshuar. Nuk jam e sigurt se do të mund t'i përmbahesha.

*Marrë nga revista "Emel"
nga boshnjakishtja: Fatmir DASHI*

BËHU SI UMU SULEJM

(Nëna e Sulejmit)

Abdumelik eIKASIM

Në Islam, çështja e martesës është madhështore, pasi është shtyllë e familjes myslimane, rrugë e gjetjes së qetësisë dhe lumturisë, si dhe mënyrë e shtimit të burrave dhe grave të mira, duke qenë shëmbëlltë e bukur dhe duke pasur edukatë të shëndoshë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka vënë dy kushte, të cilat duhet t'i plotësojnë ata që trokasën në derën e ndonjë familjeje për t'i kërkuar vajzën. Ai, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: "Nëse ju vjen dikush (për t'ju kërkuar vajzën) Feja dhe morali i të cilit ju pëlqen, martojeni" (shënon Tirmidhiu).

Ebu Talha, para se ta pranonte islamin, kishte kërkuar për martesë Umu Sulejmin, e cila i tha: Njerëz si ti nuk refuzohen, por ti je një burrë jobesimtar, ndërsa unë jam grua myslimane; nëse ti pranon Islamin, le të mbetet kjo si mehër (dhurate e martesës) për mua, ndërsa tjetër gjë nuk dua. Atëherë, Ebu Talha pranoi Islamin dhe u martuan.

Sipas një transmetimi, ajo i kishte thënë: A nuk je i vetëdijshëm se zotin që ti adhuron është nga druri, i cili mbin



nga toka, të cilin e ka mbjellë robi i filan familjeje? Po - u përgjigj ai.

A nuk ke turp të adhurosh një dru që mbin nga toka, të cilin e ka mbjellë robi i filan familjeje? Nëse ti pranon Islamin, tjetër dhuratë prej teje nuk dua.

Më jep kohë derisa ta pleqëroj - tha ai. Shkoi dhe pastaj u kthye dhe tha: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguar i Allahut.

Atëherë, ajo i tha djalit të saj, Enesit (sepse kishte qenë e martuar më herët): O Enes, ngrihu dhe jepja dorën (martoje) Ebu Talhës.

Në një transmetim tjetër, Thabiti thotë: Nuk kemi dëgjuar ndonjëherë për ndon-

jë mehër më fisnik siç ishte mehri i Umu Sulejmit, çfarë ishte ai mehër? Ishte ISLAMI.

Po ashtu, tregohet se asaj i kishte thënë: O Rumejsa (sepse ky ishte emri i Umu Sulejmit), pse nuk po përmend aspak të verdhin dhe të bardhin, d.m.th., arin dhe argjendin? Nuk dua as të verdhin as të bardhin, nuk dua tjetër përveçse të pranosh Islamin, tjetër mehër nuk pranoj në asnjë mënyrë - u përgjigj ajo.

Po çfarë mund të bëj unë në lidhje me pranimin e Islamit? - pyeti Ebu Talha.

Është Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, shko tek ai dhe dëshmoje para tij Islamin tënd - e porositi Umu Sulejmi.

U nis Ebu Talha, ndërsa Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, kur e pa, tha: *Po vjen Ebu Talha, duket në sytë e tij shkëlqimi i Islamit.*

Atëherë, ai rrëfeu se ç'i kishte ngjarë atij me Umu Sulejmin, dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i kurorëzoi ata, me të njëjtin mehër që e kishte kushtëzuar ajo.

O bija myslimane... kujdes të mos harrosh porosinë pejgamberike lidhur me zgjedhjen e bashkëshortit, mos u mashtro me dukjen e jashtme dhe stilit të kësaj dynjaje.

Çdo babai dhe vëllai i them: ki frikë Allahun e kujdes ndaj atyre që janë në kujdesin tënd. Kujdes nga tradhtia e amanetit, duke i martuar (bijat dhe motrat) me burra që s'i plotësojnë dy kushtet thelbësore: përpikërinë fetare dhe moralin! Kontribuo që të martohen me burra të mirë dhe të hairit, sepse shpëton nga mëkati dhe e bën të lumtur vajzën që ke në përgjegjësi.

Përktheu: Merita MUSLIU

Bija ime dhe periudha e pubertetit



Merva Hamza

Si të bëhesh nënë që e kupton bijën e saj në pubertet? Kjo është një pyetje që e dëgjojmë shpeshherë nga nënat që dëshirojnë t'i kuptojnë bijat e tyre në pubertet.. Dëshira e singertë për të kuptuar bijën në këtë periudhë i ndihmon nënës të këtë sjelljen e duhur. Ky kuptim, pa mëdyshje i bën dobi të gjithëve: nënës, bijës, familjes dhe tërë shoqërisë, si dhe ruan shëndetin psikik të të gjithëve.

Shumë nëna pyesin: si të sillem me bijën time, e cila ka hyrë në pubertet? Jam lodhur me të dhe personalitetin e saj të çuditshëm... E ne themi: kjo çështje ka nevojë për kuptim dhe ushtrim, ashtu siç ka nevojë për durim dhe një dozë sht-

esë të dashurisë e prehjes.

Në këtë drejtim do të japim një propozim për çdo nënë se si të sillet me bijën e saj të dashur nën dritën e fesë tonë të pastër përkitazi me sugjerimet e psikologëve.

Kam frikë për bijën time

Një nënë ka tre vajza. Vajza e madhe ka hyrë në periudhën e pubertetit. Ajo thotë: problemi im i përhershëm me vajzën e madhe është se ajo imiton shoqet e saj në mënyrën e veshjes, shkuarjen në kinema, dëgjimin e këngëve dhe përcjelljen e paskrupullt të telenovelave dhe filmave.

Një nënë tjetër thotë: e di se bija ime ka hyrë në periudhën e pubertetit, mirëpo gjestet e saj me nervozojnë, ajo vazhdimisht imiton shoqet e saj të shkollës. Më kundërshton kur unë i bëj vërejtje insistimit të saj për t'u veshur me rroba që nuk i kanë hije, daljes nga shtëpia vetëm me shoqet. Ajo dëshiron të bëjë gjithë atë që bëjnë shoqet e saj që nuk kanë kapistall, familjet e tyre u lejojnë të bëjnë ç'të duan. Kjo gjë për mua është e papranueshme, ç'të bëj?

Prej gjërave që brengosin nënat në këtë periudhë është mospajtimi në mendime me bijat e tyre.

Një nënë thotë: bija ime, që është në pubertet, nuk pëlqen asgjë përreth saj, as mendimin e nënës. Kur kam qenë në vitet e saj nuk jam sjellë në atë mënyrë, porse respektoja adetet tona.

Shohim shumë nëna që nuk lejojnë në asnjë mënyrë që bijat e tyre të mbajnë lidhje me ndonjë shoqe.

Një nënë lidhur me këtë thotë: bija ime ka një shoqe të emancipuar në një mënyrë apo tjetër, mirëpo nuk më pëlqen sjellja e saj, andaj nuk lejoj që bija ime të shoqërohet me të. E kam urdhëruar t'i ndërpresë lidhjet me të, mirëpo më kot. Bija ime insiston që atë vajzë ta ketë shoqen më të ngushtë dhe si duket kërkesën time e refuzon.

Periudhë e vështirë

Një eksperte e psikologjisë dr. Nimete Ivedullah thotë: "çdo nënë që e ka bijën në periudhën e pubertetit duhet të kuptojë se bija e saj kalon një periudhë të vështirë. Nuk duhet që t'ia shtrëngoje

bija ime, që është në pubertet, nuk pëlqen asgjë përreth saj, as mendimin e nënës. Kur kam qenë në vitet e saj nuk jam sjellë në atë mënyrë, porse respektoja adetet tona.

gjërat bijës së saj përnjëherë. Nuk duhet ta sjellë para gjërave të vështira për një çast. Të mos e ndalojë nga televizori dhe dëgjimi i këngëve përnjëherë. Konkretisht në këtë fazë disa penj duhet të lëshohen, domethënë, disa rregulla duhet t'i shohim mes gishtave për të mos na ikur zogu prej dore. Në këtë periudhë

vajza kalon prej botës së fëmijëve në botën e grave. Nëna obligohet t'i përcaktojë disa prioritete që s'guxon të shkelen si: mbulesa islame, dalja vetëm nëpër vende të dyshimta, këto gjëra asnjëherë nuk lejohen. Pas kësaj vijnë disa obligime të tjera, që mund të tolerohen kohë pas kohe. Mund t'i tolerojmë disa gjëra, duke ia bërë me dije herë pas herë se ajo është në buzë të humnerës dhe mund të bjerë në mëkate."

Sa u takon telenovelave Dr. Nimete thotë: "ndonjëherë telenovelat ngërthenë në vetvete mësimet dhe urtësi që s'do të mund t'i rrënjosim në mendjet e fëmijëve tanë, andaj, nëse ekziston ndonjë e tillë që ka dobi e mësimet, nëna duhet të mundohet që ta ndjekë së bashku me bijën, në mënyrë që t'i nxjerrë mësimet.. urtësi të mira dhe përvojë të rëndësishme. Madje, duke diskutuar me të rreth filmit, do të njohësh më thellë personalitetin e saj, gjërat që e tërheqin dhe që ka nevojë."

"Ah sikur të më kuptojë nëna"

Vashat ndihen shumë keq kur qortohen nga prindërit. Atë e shohin si një përcmim të madh për personalitetin të tyre. Një nxënëse e shkollës së mesme thotë: "Ah sikur nëna ime të kuptojë se

unë jam rritur dhe të më qortojë në një formë më të mirë.” Një tjetër thotë: “nëna ime vazhdimisht më qorton. Çdo lëvizje e imja për të është gabim, madje, çdo fjalë që e them, dhe kjo ma tret vetëbesimin.” Një tjetër, duke qarë thotë: “Ah sikur nëna ime të më kuptojë! Ndihej sikur unë jam në një luginë e ajo krejtësisht në një luginë tjetër. Ajo vazhdimisht më cilëson si e marrë, përtace.”

Rreziku i qortimit

Psikologja Inas AbdulBaki vë në dukje se vasha në pubertet nuk pranon asses qortimin e prindërve. Ajo shton “në realitet, qortimi në të shumtën e rasteve s’është i domosdoshëm, bëhet për gjëra që mund të përmirësohen më vonë, si qortimi i mënyrës së të folurit, mënyrës së ecjes, ushqimit, gjesteve, kritika kundër shoqeve. Duhet të bëjmë dallimin mes dy mënyrave të kritikës: mes asaj konstruktive, duke u marr aty për aty me gabimin, pa ia drejtuar personalisht qortimin, dhe kritikës së dëmshëm, kur qortimin ia drejton drejtpërsëdrejti, me fyerje dhe nënçmim.”

Dr. Inas mendon se rreziku i kritikës së personalitetit të fëmijës në pubertet dhe sjelljes së tij krijon mendime negative tek ai përse i përket mendimit që krijon në lidhje me vetveten. Kur e fshikullojmë me cilësitë e marra, të shëmtuara dhe nënçmuese, kjo gjë lë gjurmë negative në shpirtin e tij dhe reagimi i tij do të jetë i vrazhdë, me mllef, urrejtje dhe dëshirë për hakmarrje, apo e kundërta: duke u tërhequr dhe duke u mbyllur në vetvete.

Puna më e drejtë në këtë drejtim është mesatarja, siç thuhet: “punët më të mira janë ato mesataret”, që do të thotë: përdorim qortimin dhe lëvdatat sipas situatës, duke bërë dallimin mes personalitetit dhe cilësive gjatë kritikës.

Ajo më tej shton “çdo nënë duhet të kuptojë se bija e saj ka hyrë në një periudhë të re të jetës dhe nuk është më ai fëmijë i cili kthehet te nëna kur haset me çdo problem. Për këtë arsye, nëse dëshiron të fitosh besimin e bijës tënde dhe sinqeritetin e saj, si nënë e ke për obligim të bëhesh ndihma dhe mbështetja më e mirë për bijën tënde. Në këtë fazë duhet që nëna të jetë përgjegjësjë e parë për t’i shpjeguar çdo gjë që ka nevojë bija e saj, në të kundërt, vasha do t’u drejtohet shoqeve të saj apo

botës së internetit që është në disponimin e të gjithëve.”

Kur e fshikullojmë me cilësitë e marra, të shëmtuara dhe nënçmuese, kjo gjë lë gjurmë negative në shpirtin e tij dhe reagimi i tij do të jetë i vrazhdë, me mllef, urrejtje dhe dëshirë për hakmarrje, apo e kundërta: duke u tërhequr dhe duke u mbyllur në vetvete.

Bëhu mbështetje shpirtërore për bijën tënde

Nëna e kuptuar duhet t’i bëjë me dije bijës saj se e kupton. E kupton kur hidhërohet, lodhet dhe pikëllohet andaj i ofron ndihmë shpirtërore asaj. Dr. Shahinaze Tal’at thotë: “ti je mbështetja shpirtërore e bijës tënde duke dëgjuar me kujdes problemet e saj, duke iu përgjigjur me dashuri pa gjykuar rastin aty për aty qoftë me lëvdatë apo qortim. Bëhu mbështetje shpirtërore për bijën tënde dhe kupto ndjenjat dhe nevojat e saj (sidomos nevojat trupore dhe emocionale). Vasha në pubertet nëse nuk i ofrojmë dashuri dhe mirëkuptim, ajo do

ta kërkojë diku tjetër. Kësaj i frikësohemi dhe e refuzojmë. Kur flasim për dashurinë kemi për qëllim dashurinë mesatare dhe kuptimin e natyrës së saj në këtë periudhë.”

Periudha e pubertetit me karakteristika e saj konsiderohet kthesa më e rëndësishme nëpër të cilën kalojnë të rinjtë. Mosekzistimi i orientimit dhe dialogut në këtë periudhë mes fëmijës dhe prindërve çon deri te prishja e marrëdhënieve mes tyre. Shumë studime psikologjike kanë vërtetuar se fëmijët në pubertet që vijnë nga familjet me raporte të mira mes anëtarëve të tyre, që bashkërisht marrin vendime, janë me më pak probleme dhe më pozitiv në shikimin e jetës.”

Largoju këshillës së drejtpërdrejtë

Thirrësi islam, dr. Mebruk Atije thotë: “I Dërguari i Allahut na ka mësuar artin e sjelljes me njerëzit. Kur i arrinte ndonjë fjalë prej ndonjërit thoshte: *“ç’është puna me disa njerëz të cilët thonë kështu e kështu”* larg publikimit të emrave me një metodë të lartë morale. Këtë metodë e gjejmë edhe në Kur’an. Allahu i Madhëruar thotë: *“ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.”* (Nahël – 125) kjo është metoda e Kur’anit: thirrja me urtësi dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e atyre që i thërret në fe, fjalët që ua thotë secilën radhë për të mos i stërngarkuar dhe mënyrën si ju flet. Butësia gjatë këshillimit le gjurmë në zemrat. Qortimi, shpalosja e gabimeve që janë bërë pa dije ose me qëllim të mirë le gjurmë te vashat në pubertet.

Një nga thirrësit islam këshillon çdo

nënë dhe baba që të jenë shokë për fëmijët e tyre. Ai thotë: duhet t’i bëjmë shokë fëmijët tanë në periudhën e pubertetit. Duhet të largohemi nga stili i urdhërimit dhe ndalimit të çdo pune të madhe dhe të vogël, të lidhemi me fëmijët tanë si me shokët që kanë respekt dhe dashuri e jo me një lidhje që nënkupton urdhra dhe ndalesa, frikë dhe dënim.”

Respektimi i çështjeve vetjake

Dr. Shahinaze Tal’at thotë: “ndonjëherë të rriturit nuk e perceptojnë se sa keq e ndien veten fëmijët në pubertet kur përmenden dobësitë e tyre. Është e sigurt se nënçmimi i fëmijëve që janë në fazën e pubertetit le gjurmë të thella dhe afatgjate tek ata dhe si rezultat mund të ketë probleme psikike tërë jetën.

Ajo që e rëndon fëmijën në pubertet sjellja me të si me një vogëlush, apo të folurit për të gjëra që i pengojnë para tjerëve. Që këtu le të përkujtojmë fjalën e Allahut: *“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër”* (Huxhurat – 11)

Nëna obligohet të respektojë çështjen vetjake të së bijës pa shkelur parimin e mbikëqyrjes indirekte. Nëna ka për obligim të orientojë bijën drejt formimit të personalitetit të saj. Për t’u bërë një nënë e kuptuar patjetër duhet dhënë bijës një shans për t’u marrë me punët e shtëpisë. Për shembull: hyrja në kuzhinë, puna në të, përdorimi i drejtë i mjeteve të kuzhinës. Nëna duhet ta lavdërojë atë dhe ta kuptojë kur bija e saj gabon. T’i jep vullnet kur korr sukses dhe ta këshillojë kur gabon. Orientimi i mirë dhe i mençur shkakton që fëmija ta pranojë me zemërgjerësi nga më të vjetrit.

nga arabishtja:

Agim BEKIRI

Rreth namazit...

Përgjigjet: Ali SHABANI

Pyetje:

Shumë myslimanë që janë në punë e vonojnë namazin e drekës, ikindisë, akshamit dhe i lënë për më vonë duke arsyetuar se janë të angazhuar me punë, apo i kanë rrobat e palara. Çfarë udhëzimi u jepni këtyre? Allahu jua shpërbleftë!

Përgjigje:

Arsyet e përmendura nuk janë me vend për t'u vonuar namazi. Nuk i lejohet asnjërit nga besimtarët, burrë apo grua, që ta lërë namazin më vonë se koha e caktuar. Duhet ta falin në kohën e caktuar sipas mundësive që kanë. Allahu i madhëruar ka thënë: **“...namazi është obligim i caktuar (në kohë) për besimtarët”**. Nisa 103.

Punëtorët dhe të gjithë që janë të angazhuar me obligime në punë të ndryshme, duhen t'i kushtojnë kujdes faljes së namazit në kohën e vet dhe me xhemat në xhami, varësisht se ku gjenden. Nëse kanë afër xhami, duhet ta falin në xhami, nëse nuk ka xhami në afërsi, atëherë e falin në vendin e punës. Pejgamberit i ka ardhur një njeri i verbër dhe e ka pyetur: S'kam kush më udhëheq për në xhami, a kam lehtësim të falem në shtëpi? Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i ka thënë: *A e dëgjon ezanin?* Ka thënë:

Po. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i thotë: *Atëherë përgjigju!*

Nëse angazhimi i tij ka qenë i madh sa që nuk ka pasur mundësi të arrijë ta falë në kohën e vetë, atëherë i lejohet t'i bashkojë dy namazet drekë e iqindi dhe aksham e jaci, me kusht që kjo të mos ndodhë shpesh. Arsyeja për rrobat se i kanë të palara nuk e ndalon ta falë namazin apo ta lërë, por duhet t'i pastrojë rrobat, apo t'i ndërrojë, e jo të lihet namazi.

Pyetje:

Shumë nga myslimanët, kur sëmuren, e lënë namazin dhe thonë se kur të shërohen do ta falin kaza. A është me vend kjo arsye?

Përgjigje:

Lënia e namazit nuk lejohet përpos se në rast të ikjes së trurit, apo humbjes së vetëdijes për një kohë të gjatë, apo fëmija që nuk ka arritur pubertetin, apo gruaja gjatë ciklit menstrual, apo lehoni. Nëse njeriu është i sëmurë, por e ka vetëdijen, ai duhet ta falë namazin, dhe atë sipas mundësive. Allahu i madhëruar ka thënë: **“kini frikë Allahun sa të keni mundësi.”** Tegabun 16. I dërguari i Allahut ka thënë: *“Kur t'ju urdhëroj me ndonjë urdhër, zbatojeni atë sa të keni mundësi”*.

Po ashtu është rasti me Imran b.



Husajnin në hadithin që shënon Buhariu: Kur është sëmure Imrani, është ankuar, ndërsa Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, i ka thënë: *“Falu në këmbë, e nëse nuk mundesh, falu ulur, e nëse nuk mundesh, falu në krah”*. Në transmetimin e Nesaiut është edhe shtojca: *“e nëse nuk mundesh, falu i shtrirë”*, d.m.th., se i sëmuri që e ka vetëdijen, e falë namazin edhe me isharet (me shenja) dhe gjithashtu mund t'i bashkojë dy namaze në një kohë, si drekën me iqindinë në njërën nga kohët e këtyre namazeve dhe akshamin e jacinë, përveç sabahut, që falet veçmas.

Edhe diçka, kazaja në këtë mënyrë është keqkuptuar. Namazi që lihet me vetëdije, si mund të falet kaza?! Kjo

nuk lejohet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush fle dhe i ka kaluar namazi, apo e ka harruar, le ta falë kur t'i kujtohet, se atëherë e ka kohën e vet”*.

Pyetje:

Pas faljes së farzit, vërejmë nga xhemati se për t'i falur Synetet e ndërrojnë vendin. A ka kjo argument në fikhun islam apo jo, përndryshe ç'duhet vepruar?

Përgjigje:

Pas faljes së farzit më mirë është të bëhet dhikri që bëhet pas faljes së farzit. Kështu është udhëzimi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, siç e vërejmë në hadithet e vërteta. Mirëpo Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem,

ka ndaluar që menjëherë pas farzit të falet Syneti në të njëjtin vend dhe e ka gjykuar këtë veprim duke u thënë sahabëve “*a e ngjitet namazin?!.*” Andaj, pasi të falet farzi, nëse personi dëshiron të falë Synetin atë duhet ta ndajë prej farzit më njërën nga dy gjëra: ose më dhikër, ose me ndërrimin e vendit.

Pyetje:

A lejohet të falim namazin pas imamit që bën mëkate, si pirja e duhanit, rruajtja e mjekrës, isbali dhe të ngjashme?

Përgjigje:

Së pari e lusim Allahun fuqplotë që Allahu ata t'i udhëzojë nga këto lëshime. Është për t'u qarë ky hall më tepër se kemi rënë në kesi far situatë që imamët të dalin dhe të tillë, që e pinë duhanin e i rruajnë mjekrat – Allahu na udhëzoftë të gjithëve në rrugë të drejtë. Për këtë çështje është pyetur dijetari i famshëm Ibën Baz, i cili është përgjigjur se lejohet të falemi pas këtyre imamëve, edhe pse kemi dëgjuar se në Indi ku janë pasues të medhhebit Hanefi, nuk lejojnë dikush që rruan mjekrën të dalë imam.

Mirëpo këtu duhet të theksoj me keqardhje se ndodh që ndonjëherë të jetë imam i ndonjë xhamie dikush që bën rukje në mënyrë të ndaluar, si siher apo shkruan hajmali dhe nuska të kota, duke shkarravitur në ato fleta dhe lloje të tjera të manipulimeve, të cilat janë shirk dhe kufer - Allahu na ruajtë. Këta imamë duhen këshilluar, e nëse nuk shmangen nga ato vepra të shëmtuara, nuk lejohet të falemi pas

tyre dhe duhet insistuar që të largohet nga ajo detyrë.

Pyetje:

Kemi hasur në disa xhami para namazit, apo pas namazit, që disa nga xhemati rrinë në oborr të xhamisë dhe pinë duhan e shumë të tjerë bëjnë biseda të dynjasë, diskutojnë çështje politike etj. A është kjo në rregull dhe me çfarë na këshillon?

Përgjigje:

Xhamitë janë vendet më të dashura të Allahut të madhëruar, siç ka thënë Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, dhe ato duhet t'i dallojmë nga kafenetë dhe lokalet tjera. Xhamitë, siç thotë i dërguari i Allahut, “*janë për të falur namaz dhe për t'u madhëruar Allahu*”. Në një hadith i dërguari salAllahu alejhi ue selem thotë: “*Mos i bëni xhamitë rrugë, përveçse nëse se i përdorni për dhikër apo namaz*”. /Sahiha nr.1001/. Po ashtu transmeton Ibën Hibani dhe tjerë nga Abdullah b. Mesudi se Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Në Ahiri zaman (koha qfër Kiametit) do të ketë njerëz që do të rrinë në xhami radhë-radhë, prijës (qëllim) e kanë dynjanë, mos rrini me ata se Allahu nuk ka nevojë për ata*”.

Duhet veçuar rastet se lejohet në xhami biseda që është mubah, siç e vërejmë te hadithet ku sahabët kanë biseduar në praninë e të dërguarit salAllahu alejhi ue selem, për kohën e paditursë dhe qeshnin, e i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, buzëqeshte me ata siç është evidentuar në librin Hashijetu Ibën Abidin 1 / 445, dhe libra të tjerë të imamëve të shquar.

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

Dhikri pas namazit

59

Abduladhim b. Bedevij elHALEFIJ

1 - Resulullahu salallahu alejhi ue selem, kur kryente namazin thoshte 3 herë estagfirullah (më fal o Allah), pastaj thoshte:

2 - Allahume entes selamu ue minkes selamu tebarekte já dhel xhelali uel-ikram.

(O Zoti im, Ti je shpëtimi dhe prej Teje është shpëtimi, i Lartësuar qofsh Ti që je i Madhëruar dhe i Nderuar)

3 - La ilahe ilAllahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue hue 'ala kuli shejin kadir. Allahume la mani'a

lima a'tajte ue la m'utije lima mena'te ue la jenfe'u dhel xheddi minkel xheddu.

(S'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një dhe i pashoq. Atij i takon sundimi dhe Lavdërimi dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send. O Zoti im, nuk ka kush e ndalon atë që Ti e ke dhënë dhe s'ka kush e jep atë që Ti e ke ndaluar; (te Ti) nuk ka vlerë dobia e askujt, ngase çdo dobi vjen prej Teje)

4 - Allahumme einni 'ala dhikrike ue shukrike ue husni 'ibadetik

(o Allah, më ndihmo të të përkujtoj, të



ilmihalli

falenderoj dhe mirë të adhuroj)

5 - 33 herë subhanAllah, 33 herë elhamdulillah, 33 herë Allahu ekber dhe të njëqindën me fjalë: la ilahe vahdehuu la sherike le lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kuli shej'in kadir.

6 - leximi i ajetul kursis: Allahu La Ilahe ila huel-Hajjul-Kajjumu, la te 'hud-huhu sinetun ue la neum, lehu ma fismavati ue ma fil-erdi, men dhe ledhi jeshfe?u ?indehu ila bi idhnihi, ja?lemu ma bejne ejdihim ve ma halfehum ve la juhitune bi shej'in min ?ilmih ila bima shae uesi'a Kursijjuhus-semavati uel-erda, ue la jeuduhu hifdhuhuma ve huel-?Alijju?-?Adhim.

(Allahu është Një, s'ka Zot tjetër përveç Atij, Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përgjeshëm. Atë nuk e zë as kotja as gjumi; Gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij. Ai di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen. Nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar. Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën, kurse kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë, Ai është më i Larti, më i Madhi)

Çka urrehet të bëhet në namaz

- 1 - Prekja e trupit dhe rrobave pa nevojë
- 2 - Vendimi i duarve në bel
- 3 - Ngritja e shikimit në qiell
- 4 - Lëvizja djathtas-majtas pa nevojë
- 5 - Të shikuarit në atë që të largon vëmendjen
- 6 - Mbulimi i gojës
- 7 - Hapja e gojës
- 8 - Pështyma drejt Kiblës, ose në të djathtë
- 9 - Kryqëzimi i gishtave

10 - Shtrirja e duarve në sexhde siç shtrihet qeni.

11 - Hyrja në namaz në momentin kur shtrohet ushqimi apo duke qenë nën preston të nevojës fiziologjike

12 - Tejkalimi i imamit gjatë lëvizjeve në namaz

Çka lejohet gjatë namazit

- 1 - Të ecurit me nevojë
- 2 - Bartja e fëmijës
- 3 - Vrasja e akrepit dhe gjarprit
- 4 - Të kthyerit në namaz dhe tregimi me shenjë për nevojë
- 5 - Pështymja në rroba ose nxjerrja e mindilit prej xhepit
- 6 - Kthimi i selamit me shenjë atij që i jep selam
- 7 - Thënia e burrave "subhanAllah" dhe rënia e shuplakave për gratë nëse ndodh diçka në namaz
- 8 - Ofrimi i ndihmës imamit në raste kur i përzihet leximi
- 9 - Pengimi i atij që dëshiron të kalojë përpara falësit të namazit
- 10 - Të qarit

Ç'ka e prish namazin

- 1 - Prishja e abdesit.
- 2 - Lënia e ndonjë rukni, ose ndonjë sharti me qëllim, pa arsye
- 3 - Ngrënia dhe pirja me qëllim.
- 4 - Të folurit e fjalëve që s'kanë të bëjnë me namazin
- 5 - Të qeshurit.
- 6 - Kalimi i gruas së moshuar para namazliut mes vendit të tij dhe vendit të sexhdes
- 7 - Kalimi i gomarit dhe qenit të zi, para namazliut mes vendit të tij dhe vendit të sexhdes.

Zgjedhje: Agim BEKIRI

Njëzet Hadithe Të Zgjedhura Nga Sahihu I Muslimit

Autor: Abdulmuhsin b. Hamed el-Abbad


Shkruan: Talha KURTISHI

Syneti si burimi i dytë i legjislacionit Islam, si komentues i Kur'anit dhe ndriçues i dispozitave fetare e ka merituar mundin dhe angazhimin e dijetarëve ta hadithit, të cilët duke e mësuar, shënuar, ruajtur dhe përhapur Synetin e kanë ruajtur fenë islame si domosdoshmëri e parë në jetën e muslimanit.

Allahu, i Lartësuar thotë: **“O ju që besuat, respektojeni Allahun dhe të dërguarin e Tij, e mos e braktisni atë se ju po e dëgjoni...”** (El Enfāl, 20)

Thuaj (o i dërguar): “Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur. (Et Tevbe, 24)

Thuaj: “Respektojeni Allahun dhe respektojeni të dërguarin!” Nëse ata refuzojnë, atëherë atij i takon



61

përgjegjësia me çka është i ngarkuar ndërsa juve përgjegjësia me çka jeni të ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë. (En Nur, 54)

Respektimi i të dërguarit manifestohet duke e besuar atë që ai na e kumton, duke i zbatuar urdhrat e tij dhe duke u larguar nga gjërat që ai i ka ndaluar. Një formë e veçantë e respektit është angazhimi për grumbullimin, kodifikimin, kontrollimin dhe përhapjen e Synetit të tij, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të.

Islamit gjatë historisë, nuk i kanë munguar shërbyes që me devotshmëri dhe amanet bartën porositë hyjnore tek gjeneratat e mëvonshme. Ata nuk kursyen as kohë e as mund për të tubuar, shënuar dhe përhapur trashëgiminë që pas vete e la i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, shokët e tij dhe dijetarët e gjeneratave të dalluara.

Angazhimet e tyre edhe sot përmenden si shembull i përkushtimit,

sakrificës, kujdesit dhe besnikërisë ...

Shoqëritë moderne dhe mjetet e komunikimit e kanë lehtësuar veprimtarinë shkencore, situatë kjo e cila udhëtimet e dijetarëve të hadithit,, vuajtjet dhe durimin e tyre e ngrit në shkallën e mrekullisë.

Margolith, një orientalist i njohur thotë: “Myslimanët kanë plotë të drejtë të krenohen me shkencën e hadithit.” (El Mu’alimi, El Mekalat El Ilmijje, fq. 253)

Muhamed Behaud-din në librin e tij “El Musteshrikun uel Hadith En-Nebevi, fq. 30 thotë: “Shumë nga metodat që i përdorën myslimanët në vlerësimin e saktësisë së hadithit sipas tekstit (el -metn) dhe sipas vargut të transmetuesve (el -isnad), e që janë shpjeguar në shkencat e hadithit (Mustalah El Hadith ve El Xherh vet Ta’dil) u mirëpritën dhe u zbatuan nga shumë perëndimorë në verifikimin e transmetimeve historike. Si shembuj do ti përmendim, Karlajlin, Bernard Sho-në, Smit-in dhe tjerë. Të gjithë ishin të fascinuar me mënyrën e tubimit të hadithit dhe me rregullat e kritikës ndaj transmetuesve.”

Një kolos i shkencës së hadithit është edhe imami i njohur, Imam Muslimi (204 – 261 H që korrespondon me 819-874 të kalendarit gregorian) dhe dëshmia e angazhimit të tij vepra Es Sahih, nga e cila dijetari i respektuar Abdul Muhsin El Abbadi ka përzgjedhur dhe në mënyrë shkencore ka komentuar njëzet hadithe.

Është për të përhëndetur vendimi i profesorit të nderuar Rexhep Nuredini që këtë libër ta përkthen në gjuhen shqipe dhe kështu ta sjell më afër lexuesve shqipfolës. Jemi të mendimit se ky hap i guximshëm do ti nxit edhe hoxhallarët tjerë që të angazhohen më tepër në përkthimin e librave të hadithit .

Përkthimi në fjalë është i veçantë në disa elemente:

Hyrje (parathënie) e dobishme që përfshin biografinë e autorit dhe shtjellon gati se në hollësi gjitha temat të lidhura më veçoritë dhe dallueshmërinë e Sahihut si libër i dytë i Syneetit pas Sahihut të Buhariut nga aspekti i vërtetësisë.

Parathënia e librit përmend edhe biografinë e Muslimit, shkakun e përpilimit të librit, krahasimin mes tij dhe Sahihut, vërejtjet e disa dijetarëve, librat që e kanë komentuar veprën në fjalë etj.

Gjatë komentimit të haditheve përpiluesi i librit u është përmbajtur këtyre pikave:

Përmendja e gjitha burimeve ku gjendet hadithi në fjalë

Të dhënat mbi vargun e transmetuesve ku ka përmendur shkurtimisht biografinë e çdo transmetuesi.

Veçori tjera mbi vargun dhe faktet që dalin nga shkenca e terminologjisë së hadithit.

Komentimi i hadithit


Nxjerrja e dispozitave dhe urtësive që dalin nga hadithi.

Nga hadithet që i ka përmbledhur autori janë: hadithi i dërgimit të Muadhit në Jemen, mbi Ebu Talibin, mbi besimin e paluhatshëm, mbi ruajtjen e sekretit etj.

Besojmë se ky përkthim do ta pasuron bibliotekën e hulumtuesit profesional si dhe bibliotekën e lexuesit të thjeshtë që prej së afërmi dëshiron të njohet me trashëgiminë pejgamberike.

Me shpresë që këtu nuk do të ndalet veprimtaria e profesorit të nderuar e lusim Allahun që veprat tona të mira t’i pranon dhe të na i lehtëson vështirësitë e Ditës së Fundit, Ai me të vërtetë i pranon lutjet e robërve të Tij.

Ju dëshirojmë çaste të këndshme me leximin e librit.



1. Komentit i sures Fatiha
Autor: Ibn Kethir
Muhammed el-Uthejimin
Selman el-Aude

LIBRA TË REJA NGA SH. B. "NUN"



- Bazat e imanit në dritën e Kuranit dhe Sunetit
Grup autorësh 4.



2. Zëri i shejtanit
Autor: Abdulaziz Abdulhetaf Revah



3. Rrëfime të mrekullueshme profetike
Autor: Muhamed Xhemil Zejno

Flügger Decor



*** FLUGGER GJALLËRON DHE ZGJATË JETËN E AMBIENTIT TUAJ.**

*** MBI 3000 NIANSA TË NDRYSHME**

F.a.g - Kom
Shkup - Magedoni

Tel : + 389 (2) 2600 154
Faks : + 389 (2) 2601 248
rr. Xhon Kenedi nr. 9a lok.14

E-mail : fag_color@yahoo.com
Web : Flugger.com